



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për auditimin tematik të ushtruar në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë dhe Bashkinë Këlcyrë: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2021 deri 30.06.2021”

RAPORTI I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË 2 AUDITIMET E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN
01.01.2021 DERI 30.06.2021, AGJENCIA E PARQEVE DHE
REKREACIONIT, BASHKIA TIRANË DHE BASHKIA KËLCYRË”**

Tiranë, 2022

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	3 - 5
	I/1. Hyrje.....	
	I/2. Objektivat e auditimit.....	
	I/3. Qëllimi i auditimit.....	
	I/4. Metodologjia auditimit.....	
	I/5. Konkulzione.....	
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	5 - 6
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	6 -77
	<i>III/1 Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë.....</i>	<i>6 - 34</i>
	<i>III/2 Bashkia Këlcyrë.....</i>	<i>35 - 77</i>
IV	ANEKSE.....	77 - 81

I. PËRMBLEDHJE:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **2** subjekte, respektivisht: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Këlcyrë mbi: “*Verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në vitin 2021 për periudhën 01.01.2021 – 30.06.2021*, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{se} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021;
- Hartimi i programeve (*plan veprimeve*) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si; vendimeve (*urdhrave*) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore;
- Vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, si IMTV, Komisioneve të Licencave, APP, e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

Në përfundim të procesit të punës audituse në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të paraqitura nga subjektet në fazën e Projekt Raport Auditimit, gjetjet e konstatuara të cilat janë reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, situata e zbatimit të rekomandimeve në **2** subjektet e audituara, *paraqitet si vijon:*

Sipas lloje të masave dhe statusit të zbatimit të rekomandimeve, kemi këtë situatë:

Nga 2 subjektet e audituara, kanë kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve, gjithsej 1 subjekte ose 50% dhe në afatin e 6 muajve, nuk është kthyer përgjigje nga 2 subjektet.

-26 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 26 masa organizative prej tyre, janë zbatuar 4 masa organizative, dhe nuk janë zbatuar 22 masa organizative nga 1 subjekte. (*sipas pasqyrës Aneks 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*);

-8 masa shpërblim dëmi në vlerën **17,789 mijë lekë**, janë pranuar të 8 rekomandimet, në vlerën **17,789 mijë lekë**. Nga të cilat janë zbatuar 2 rekomandime në vlerën **1,447 mijë lekë**, (të cilat janë zbatuar apo ndodhen në proces gjyqësor), dhe nuk janë zbatuar nga 1 subjekte 6 rekomandime në vlerën **16,342 mijë lekë**. (*sipas pasqyrës Aneks 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*);

-1 masa mos efektivitet të fondeve publike (3-E) me vlerë 183,894 mijë lekë, të cilat pranuar 100% nga subjektet. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 1 masa me vlerë 183,894 lekë. (*sipas pasqyrës Aneks 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*);

-5 masa mungesë të ardhurash me vlerë 101,295 mijë lekë, të cilat pranuar 5 masa me vlerë 101,295 mijë lekë. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 2 masa me vlerë 45,325 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 17,646 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 27,679 mijë lekë. Nuk kanë filluar akoma procesin e zbatimit 3 masa me vlerë 55,970 mijë lekë. (*sipas pasqyrës Aneks 4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*);

-10 masa disiplinore të cilat janë pranuar 10 masa disiplinore, nga masat e pranuar janë zbatuar 10 masa disiplinore, nuk ka masa disiplinore të pa zbatuara. (*sipas pasqyrës Aneks 5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*);

-24 masa administrative, nga të cilat janë pranuar 36 masa. Nga masat e pranuar janë zbatuar 5 masa administrative, 21 masa administrative janë në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar 10 masa administrative nga 2 subjekte. (*sipas pasqyrës Aneks 6 bashkëlidhur*

Raportit Përfundimtar të Auditimit).

I/1. HYRJA:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH-së”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 445 prot., datë 05.05.2022 dhe autorizimet nr. 445/1-445/2 prot., datë 05.05.2022, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 09.05.2022 deri në datë 20.05.2022, u krye auditimi në 2 subjekte, respektivisht: në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Këlcyrë mbi: “Verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer për periudhën 01.01.2021 – 30.06.2021”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1.H. I. (Përgjegjës grupi)

2.A. G. anëtar

- Çështjet e Audituar:

1. Hartimi i programit (*Plan veprimit*) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthim përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 germa (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftim raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, përcaktuar në pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

3. Realizimi i rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacion në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuara nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

5. Realizimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik, nga nxjerrja e akteve administrative, regjistrimi në kontabilitet, deri në arkëtimin e vlerës, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

6. Realizimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative, nga nisja e procedurave për dhënien e masave, komunikimi zyrtar me personat përkatës dhe vendosjen në dosjen personale, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

I/2. Objekti i auditimit: Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

I/3. Qëllimi i auditimit: Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit

31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e auditimit: Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësive në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni: Nga përfundimi i punës në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekteve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH^{ja}, rezulton se:

Nga gjithsej **433** masa (*organizative, shpërblim dëmi, 3-E, mungesë të ardhurash, disiplinore dhe administrative*), janë pranuar nga subjekti 426 masa ose 98%. Nga të pranuarat janë zbatuar dhe në proces zbatimi 338 masa ose 80% dhe janë zbatuar akoma 86 masë ose 20%.

Ndërsa në vlerë, nga vlera e rekomanduar prej 3,555,592 mijë lekë janë pranuar nga subjekti vlera prej 3,523,129 mijë lekë ose 99%. Nga vlera e pranuar është zbatuar dhe në proces zbatimi vlera prej 2,895,632 mijë lekë ose 82% dhe nuk ka filluar të zbatohet vlera prej 649,961 mijë lekë ose 18%.

Nga sa shikohet niveli i zbatimit të rekomandimeve është në nivelet 80% si numër dhe 86% si vlerë, gjë e cila tregon se nga subjektet është vlerësuar procesi i zbatimit të rekomandimeve, por duhet të përqendrohet akoma më shumë në arkëtimin e vlerave të paarkëtuara dhe të proceseve gjyqësore, kjo për të eliminuar kalimin e afateve ligjore të kërimit të vlerave, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve :

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i realizimit të rekomandimeve është 80%, për disa nga masat subjektet e audituara nuk ka mundur nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit Punës në Republikën e Shqipërisë (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (*vlerave*) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit “Për kundërvajtjet Administrative“ (*brenda 2 vjetësh*), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2021 - 30.06.2021.

III/1. AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT, BASHKIA TIRANË

-PËRMBLEDHJE:

Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditim në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë mbi: “Verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e

evaduara në vitin 2021 për periudhën 01.01.2021 - 30.06.2021, paraqitur me shkresën nr. 328/7 prot, datë 09.03.2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me: Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i evaduar në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si; vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore, vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, si IMTV, Komisioneve të Licencave, APP, e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.328/7 prot, datë 09.03.2021, ndërsa nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj 392/5 Prot. datë 25.03.2021. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë **brenda 20 ditësh**, në zbatim me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor** nga momenti i dërgimit të shkresës për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, konstatohet se me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.328/7 prot, datë 09.03.2021, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 09.09.2021. Nga ana e Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 4 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 4 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht.

Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa me vlerë 1,447,958 lekë, deri me datë 20.05.2022, ndodhet në proces gjyqësorë **vlera 863,698 lekë**, ndërsa **vlera 584,260 lekë** është në proces arkëtimi.

Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet një rekomandim me 11 gjetje në vlerën **183,894 mijë lekë**, e pranuar dhe në procese zbatimi.

Për mungesë të ardhurash, janë rekomanduar **2** masa me vlerë **45,325 mijë lekë**, është arkëtuar vlera 17,646 mijë lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 27,679 mijë lekë.

Për masat administrative i është rekomanduar APP 20 masa administrative, të cilat janë pranuar 100% nga subjekti. Në lidhje me masat administrative adresuar APP, nga 20 punonjës të rekomanduar, nga APP është marrë vendim për 31 punonjës me vlerë 1,620,000 lekë, nga ku rezulton se deri në momentin e verifikimit, ka filluar ndalesa për mbajtjen nga paga 9 punonjës në vlerën 540,000 lekë, ndodhet në proces gjyqësorë 11 persona në vlerën 680,000 lekë si dhe nuk është kryer asnjë procedurë për 6 persona në vlerën 400,000 lekë

- Ndërsa në lidhje me masa adresuar IMT Bashkia Tiranë, kjo për 1 (një) person nuk ka filluar akoma procesi i zbatimit.

Për masat disiplinore i është rekomanduar APR të vlerësoj shkeljet e konstatuara nga KLSH si dhe të vendos masë disiplinore “Vërejtje” për 4 persona, masa të cila konsiderohen të realizuara.

- Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve :

Niveli i realizimit të rekomandimeve është mbi 82%. Nga masat, APR ka mundur nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, duke i shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë ka filluar kryerja e ndalesave, sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Planit të veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, sic është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j), ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.328/7 prot, datë 08.03.2021, ndërsa nga Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 392/5 Prot. datë 25.03.2021. Pra përgjigja e APR për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë **brenda 20 ditësh**, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 392/5 Prot. datë 25.03.2021 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.328/7 prot, datë 08.03.2021,dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 12.10.2021.

Nga ana e Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, *ku përcaktohet se*: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna dhe ngarkon me përgjegjësi Nëpunësin Autorizues.

Pa zbatuar

3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë 4 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 3 masë organizative dhe zbatuar pjesërisht 1 masë. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen pak. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, *rezultoi se:*

Në lidhje me mjedisin e kontrollit. Është hartuar Rregullorja e funksionimit të APR-^{së}, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh. Nuk është hartuar “*Deklarata Vjetore*”, mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nuk janë dorëzuar sipas afateve ligjore të caktuara në nenin 18, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe pikat 4 e 6, të Udhëzimit të MF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

Në lidhje me menaxhimin e riskut: APR ka miratuar regjistrin risqeve, por nuk ka asnjë procedurë të dokumentuar për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Në lidhje me aktivitetet e kontrollit: Nuk janë nxjerrë urdhra në miratim të gjurmës së auditimit, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde zbatimit të buxhetit” pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4 pika 19 dhe neni 16 pika 2.

-Në lidhje me informacionin dhe komunikimin: Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, postë elektronike dhe në mënyrë verbale, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme pa përfshirë komunikimin elektronik.

APR në varësi të Bashkisë Tiranë, mbulohet nga Auditi i Bashkisë Tiranë. Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse, si: për marrjen në dorëzim të punimeve të kontraktuara, në rastet e identifikimit të detyrimeve. (*Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.1 faqe 18-19*).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, me atributet e Nëpunësit Autorizues dhe Koordinator i Riskut, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve dhe miratimin e gjurmëve të auditimit, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Të hartohet “*Deklarata vjetore*”, mbi cilësinë dhe gjetjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, veprim i cili shërben për certifikimin e veprimtarisë së menaxhimit financiar dhe kontrollit të kësaj njësie.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

1.2.Nga verifikimi rezultoi se: Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar Regjistrin e Riskut i cili i përcillet Bashkisë Tirane çdo vit së bashku me PBA

Referuar Urdhrit nr. 14961 date 20.04.2022 “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik” dhe anekset përkatëse, Bashkia Tiranë do të bëjë të mundur dhe implementimin e të gjithë procesit në zbatim të ligjit të menaxhimit financiar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se, në zbatim të Vendimit të KB nr. 49, datë 26.04.2018 “Për kalimin e administrimit të “Parkut Rinia”, si park rekreativ me gjithë elementët përbërës (*bimësi, kosha, infrastrukturë pa ndriçim publik me nr. 7/322, ZK nr. 8380, me sipërfaqe 24910 m²*), nga Drejtoria e Përgjithshme nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit tek Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit”, nuk është bërë kalimi në administrim i “Parkut Rinia” si park rekreativ me gjithë elementët përbërës (*bimësi, kosha, infrastrukturë pa ndriçim publik*).

Megjithëse me urdhrin nr. 25882, datë 03.07.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e proceduarave për kalimin e Aseteve dhe kryerjen e inventarit fizik, nga Drejtoria nr. 1 e punëtorëve të Qytetit tek Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit”, të Zv/Kryetarit të Bashkisë z. A. M., është ngritur komisioni prej 7 personash, me përfaqësues nga Drejtoria Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, u konstatua se nuk është kryer asnjë veprim për kryerjen e inventarit fizik dhe kalimin në administrim të “Parkut Rinia” nga Drejtoria nr. 1 e punëtorëve të Qytetit tek APR^{ja}, në zbatim të Vendimit të KB nr. 49, datë 26.04.2018.

Nga verifikimet në terren të kryer në territorin e “Parkut të Madh të Liqenit”, nga grupi i auditimit të KLSH^{së} dhe përfaqësues të APR, janë konstatuar një mori ndërtimesh private (lokale), për të cilat APR^{ja} nuk disponon një planimetri të përgjithshme mbi planvendosjen e tyre, të shoqëruar me Gentplanet përkatëse, duke mos u qartësuar se ku është territori i Bashkisë Tiranë që administrohet nga APR^{ja} dhe ku është kufiri i lokaleve private, kjo për të identifikuar sipërfaqen ku APR^{ja} duhet të kryej shërbimet e mirëmbajtjes. (*Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.3 faqe 26-38*).

2.1. Rekomandimi: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë në bashkëpunim me sektorët përkatës në Bashkinë Tiranë, të marrë masa për zbatimin e urdhrin nr. 25882, datë 03.08.2018, me qëllim kalimin në administrim me inventarë fizik, të sipërfaqes së “Parkut Rinia”.

2.2. Rekomandimi: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, të krijojnë një grup pune me specialist të fushës, me qëllim inventarizimin e të gjithë objekteve të vendosura në sipërfaqen e “Parkut të Madh të Liqenit”, për të saktësuar sipërfaqet në pronësi të Bashkisë Tiranë që administrohet nga APR-ja, për kryerjen e shërbimeve e mirëmbajtjes.

Brenda datës 31.12.2020

2.3. Nga verifikimi rezultoi se: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me shkresën nr. 1769 prot., datë 08.10.2021 i është drejtuar Bashkisë Tiranë, me lëndë “Kërkesë për realizimin e inventarit fizik të asetëve në parkun Rinia dhe përfundimin e procesit të kalimit në administrim të parkut. Në vijim të korrespondencës Bashkia Tiranë me shkresë nr. 15064 prot., datë 21.04.2022, është dërguar VKB nr. 27, datë 06.04.2022 “Për transferimin kapital pa pagesë të vlerës së investimeve të kryera nga Aparati i Bashkisë Tiranë tek Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit” Aktualisht janë në fazën e verifikimit në terren.

Gjithashtu në zbatim të Vendimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me Urdhrin nr. 180, datë 28.04.2021 “Për inventarizimin e objekteve në Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës” është ngritur grupi i punës. Në përfundim të procesit është paraqitur relacion i grupit të punës me shkresën nr. 1705/1, datë 01.10.2021, së bashku me hartën ku janë identifikuar sipërfaqet private që ndodhen të pozicionuara në PMLAT

Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin dhe miratimin e buxheteve, u konstatua se:

- Kërkesat për rishpërndarje fondesh, jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analizë, ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat Standarde të zbatimit të Buxhetit”, me ndryshime.

- Në rishpërndarjen e fondeve gjatë vitit ushtrimor, transferimet e fondeve për investime, u konstatua se rishpërndarja e tyre gjatë vitit ka ndikuar negativisht në realizimin e planit të buxhetit dhe të vetë projekteve. Realizimi i planit të buxhetit për vitin 2018, ka qenë plani 599,503 mijë lekë, realizuar 528,643 mijë lekë pra 88%, ndërsa për vitin 2019, plani 640,418 mijë lekë, realizuar 584,345 mijë lekë pra 91%. Kjo tregon për një performancë jo të mirë të planifikimit të buxhetit.

-Për periudhën e vitit 2019, është konstatuar fenomeni i likuidimit të faturave jashtë afatit 30 ditë nga momenti i dorëzimit të tyre në APR në shumën 37,233 mijë lekë, nga e cila shpenzimet operative në vlerën 4,701 mijë lekë dhe investime në vlerën 32,556 mijë lekë.

Është evidentuar fenomeni i përqendrimit të likuidimit të shpenzimeve në fund të vitit buxhetor, ku faturat e papaguara në 31.12.2019 shkojnë në vlerë 37,233 mijë lekë. (Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.2, faqe 19-26).

3.1 Rekomandimi: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Planifikimi dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta, ku prioritet të kenë detyrimet e paguara të vitit paraardhës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i realizuar pasi me shkresën nr. 1485/1 prot., datë 30.10.2020 është dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, në Bashkinë Tiranë, tavanet Buxhetore të PBA-së 2021-2023 të cilat janë miratuar me VKB nr. 172 datë 21.12.2020, përcjell në APR me shkresën nr. 1272prot., datë 12.01.2021.

Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të punëve publike, konstatohet se nga Autoritet Kontraktor (AK), janë realizuar në mënyrë periodike, procedura prokurimi me objekt: “Shpenzimet për mirëmbajtjen rrugore” dhe “Ndërtimi i rrugëve të brendshme të Parkut”, me fond limit 39,229 mijë lekë. Në të gjitha këto procedura, APR-ja projekt preventivat e këtyre objekteve për segmentet rrugorë të cilët do ti nënshtrohen rehabilitimit, nuk është përcaktuar më parë harta e segmenteve rrugore të “Parkut të Madh të Liqenit Artificial”. (Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.3, faqe 88-96).

4.1. Rekomandim: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, të marrë masa për ndërtimin e hartës së segmenteve rrugore tek “Parkut të Madh të Liqenit Artificial”, në të cilën të jetë përcaktuar “pika zero” e rrugëve të këtij Parku dhe kilometrazhi për çdo segment rrugor, në mënyrë që të bëhet i mundur planifikimi dhe kontrolli i saktë i rehabilitimit të këtyre rrugëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i realizuar pasi me Urdhër nr. 181, datë 28.04.2021 “Për marrjen e masave për zbatimin e rekomadimeve të raportit përfundimtar të auditimit” është ngritur grupi i punës për ndërtimin e hartës së segmenteve rrugore në Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës. Në përfundim të procesit grupi i

punës ka paraqitur relacionin me shkresën nr. 1705 prot., datë 30.09.2021, shoqëruar me hartën e segmenteve rrugore që ndodhen në PMLAT.

Zbatuar

C/I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH-së* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe pikën 93, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (*Padi gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi Zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,447,958 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “*Rikonstruksioni i amfiteatrit*”, me vlerë 47,429,258 lekë dhe kontraktues shoqërinë “F.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **863,698 lekë pa TVSH**, konkretisht në zërat e punimeve “*FV hekur period Ø 6-10 mm*”, “*Shtresë mozaik mermeri t=20 mm*”, “*Shtresë betoni për nivelim*”, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. .../9 prot, datë 06.07.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor dhe shoqërisë “F.” SHPK. (*Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.3.1, faqet 88-96*).

1.1. Rekomandimi: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për shpërblim dëmi në vlerën **863,698 lekë pa TVSH** nga shoqëria “F.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të kontratës së punimeve nr. .../9 prot, datë 06.07.2017, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2020

1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me shkresën nr. 1822 prot., datë 18.10.2021 drejtuar subjektit “F.” SHPK me lëndë “*Njoftim për përmbushje detyrimi*” duke i kërkuar likuidimin vullnetar të detyrimit Nga ana e OE “F.” SHPK është bërë kundërshtimi i detyrimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë sipas nr. 1696 Akti datë 20.01.2022 protokolluar pranë APR-së me nr. 105 prot., datë 24.01.2022. (vlera e dëmit ekonomik është mbajtur nga vlera e garancisë së punimeve e cila nuk ka qënë lëvruar nga APR gjatë kohës së zhvillimit të auditimit).

Zbatuar realizimi në proces

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “*Rikonstruksioni i parqeve memoriale (ndërtim/ montim)*”, me vlerë 14,023,115 lekë dhe kontraktues shoqërinë “L.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **584,260 lekë pa TVSH**, konkretisht në zërat e punimeve “*FV hekur betoni*”, “*Shtresë betoni C12/15*”, “*Veshje muri me pllaka guri të skalitur*” dhe “*Restaurim i shtresës me pllaka guri*”, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. .../11 prot, datë 29.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor dhe shoqërisë “L.” SHPK. (*Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.3.1, faqet 88-96*).

2.1. Rekomandimi: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për shpërblim

dëmi në vlerën **584,260 lekë pa TVSH** nga shoqëria “L.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës nr. .../11 prot, datë 29.07.2019, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2020

2.2.Nga verifikimi rezultoi se:Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit në vijim të korrespondencave të zhvilluara me subjektin “L.” SHPK me shkresën nr. 1669/1 prot., datë 18.10.2021 drejtuar subjektit për “Përmbushje detyrimi” duke i kërkuar likuidimin vullnetar të detyrimit. Nga ana e OE me shkresën nr. 1669/2 datë 16.12.2021 është bërë kundërshtimi i detyrimit. Deri në momentin e verifikimit nuk është bërë likuidimi i vlerës së dëmit ekonomik si dhe nuk është çliruar vlera e garancisë së punimeve.

Në proces zbatimi

C/II. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi 01.09.2017 – 31.12.2019 nga subjekti Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, janë zhvilluar gjithsej **93** procedura prokurime me fond limit 492,124 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate prej 463,885 mijë lekë pa TVSH.

Mbi bazën e materialitetit dhe riskut janë vlerësuar për auditim **44** procedura me vlerë kontrate 363,846 mijë lekë pa TVSH, nga ku kanë rezultuar me shkelje **11** procedura me vlerë kontrate 183,894 mijë lekë pa TVSH ose 50.5% e procedurave të audituara, pasi për **3** procedura disa nga kriteret e vendosura në DST, të hartuara nga Njësia e Prokurimit dhe të miratuara nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës (*zërat e preventivave*), veprime të cilat direkt ose indirekt eliminojnë mos pjesëmarrjen e Operatorët Ekonomik (OE) në garë ose janë kriteret për skualifikim të OE pjesëmarrës, ndërsa në **8** procedura OE/BOE janë shpallur fitues dhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të hartuara nga NjHDT dhe të miratuara nga Titullari i AK, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të DST, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **183,894 mijë lekë pa TVSH**, nga e cila për vitin buxhetor raportues 2019 në vlerën 116,123 mijë lekë dhe për periudhës para vitit buxhetor 2019 (pra 2017 – 2018), në vlerën 67,771 mijë lekë, në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 2, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 66 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *konkretisht rastet:*

1. Në tenderin me objekt: **“Rikonstruksion i parqeve memoriale (Ndërtim Montim)”**, me fond limit 15,579,200 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqërinë “L.” SHPK, me vlerë 11,685,929 lekë pa TVSH.

Në vendosjen e kriterëve, konstatohet se nga AK janë kërkuar kriteret të paargumentuara, konkretisht:

- “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçencë Profesionale të shoqërisë, për restaurimin e monumenteve të arkitekturës.
- CZ – Zbatim për punimet e restaurimit të monumenteve të arkitekturës”.

Nisur nga zërat e preventivit të punimeve, të dy këto kriteret janë të paargumentuar teknikisht dhe nuk duhej vendosur.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se OE i shpallur fitues "L." SHPK, ka rezultuar se në dokumentacionin e paraqitur për automjetin "Eskalator mungon", leja e qarkullimit nuk është paraqitur, duke mos plotësuar kriterin 8/a.

Në kontratat e bëra për marrjen me qira të mjeteve, në asnjë kontratë nuk është specifikuar objekti i prokuruar, duke mos plotësuar kriterin 8/c. Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

2. Në tenderin me objekt: **"Shërbime të tjera, prodhim i lëndës drusore"**, me fond limit 33,332,830 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqërinë "A." SHPK, me vlerë 33,312,951 lekë pa TVSH.

Nga auditim i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se OE i shpallur fitues "A." SHPK, nuk plotëson të gjithë kërkesat e DST të miratuara nga AK, konkretisht: 1- Mungon bilanci 2018, në kundërshtim me pikën 3.2.1 të KVK;

- Nuk është e përcaktuar në dokumentacionin e paraqitur, që disponohen mjete transporti dhe financiare për të shfrytëzuar jo më pak se **5000 m³** lëndë drusore në vit, në kundërshtim me pikën 3.3.3 të KVK ;

- Punëtorët janë të certifikuar nga vetë shoqëria, në kundërshtim me pikën 3.3.6 të KVK.

Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

3. Në tenderin me objekt: **"Blerje Karburanti"**, me fond limit 48,328,077 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues BOE "A. & O." SHPK, me vlerë 48,328,077 lekë pa TVSH.

Nga auditim i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se BOE i shpallur fitues "A." sha & "O." SHPK, nuk plotëson kriterin 2.3 "Kapaciteti teknik", pika 11.

BOE ka paraqitur një dokument i quajtur "Faqja e Menaxhimit të Karburanteve", i cili është një dokument vetëm me logon e shoqërisë "B." dhe të shoqërisë "O." SHPK, por jo kontratë e nënshkruar nga palët. Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

4. Në tenderin me objekt: **"Rehabilitimi i godinës së Varrezave të dëshmorëve (Ndërtim Montim)"**, me fond limit 5,691,299 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqëria "V." SHPK, me vlerë 5,405,212 lekë pa TVSH.

Mbi përcaktimin kriterëve të kualifikimit:

- Nisur edhe nga zërat e përfshira në preventivin e punimeve, rezulton që kriteri për punësimin e një **arkitekti**, të jetë i paargumentuar teknikisht dhe për pasojë nuk duhej vendosur.

- Nisur nga volumet e preventivit dhe zërat e punës, kërkesa për "Sharrë për prerje guri", "Rrol për shtresat, kapaciteti 4 ton", "Autobetonjere + pompë betoni" dhe "Makineri e lëvizshme me pajisje speciale për testimin e materialeve të ndërtimit", janë të paargumentuara teknikisht dhe për pasojë nuk duheshin vendosur.

Mbi vlerësimin e ofertave.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë në pjesë 3 OE, nga të cilët janë kualifikuar 2 dhe janë skualifikuar 1 OE.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se OE i shpallur fitues "V." SHPK, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, të miratuara nga AK, konkretisht:

- Dokumentacioni i paraqitur për "Makineri e lëvizshme me pajisje speciale për testimin e materialeve të ndërtimit" është për automjetin tip "Iveco 49 E 12", i cili është mjet që regjistrohet në regjistrat publikë. Për këtë mjet është paraqitur kontrata me shoqërinë "F." SHPK me nr.rep, datë 30.05.2019 dhe deklarata doganore për mjetin, por nuk paraqiten dokumentet e kërkuara në KVK si më poshtë: "Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus

certifikatën e kontrollit teknik , siguracioni e mjetit(të vlefshme) dhe lejen e transportit, dhe për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni e mjetit dhe lejen e transportit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi”.

- Për inxhinieren e mjedisit A. B., nuk është paraqitur certifikata e lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

5. Në tenderin me objekt: **“Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative (materiale reaktive, banera, instilacione, kupa, medalje)”**, me fond limit 831,340 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqëria “B.” SHPK, me vlerë 830,000lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se OE i shpallur fitues “B.” SHPK, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, të miratuara nga AK, konkretisht:

- Nuk plotëson pikën 3.2.5 të DST, pasi certifikata e paraqitur ISO EN 3834-05, nuk është sipas modelit të kërkuar në DST, e cila duhej ISO EN 3834-2015, si dhe emërtimi që kërkohet (për arredim indorr...).

Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

6. Në tenderin me objekt: **“Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”**, me fond limit 2,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqërinë “Z.” SHPK, me vlerë kontrate 2,444,444 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se edhe OE i shpallur fitues “E.” SHPK, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, të miratuara nga AK, konkretisht:

- Nuk plotëson pikën 2.2.1 të DST, ku kërkohet paraqitja e pasqyrave financiare të certifikuar për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Nga shoqëria është paraqitur me certifikatë vetëm pasqyrat e vitit 2016, ndërsa vitet 105 dhe 2017 nuk kanë raport certifikimi.

- Nuk plotësohet pika 2.12 e DST, ku kërkohet 3 punonjës të siguruar si montues. Nga shoqëria vetëm është deklaruar fakti se ka punonjës montues, por nuk ka të evidentuar emrat e tyre dhe dokumentacioni justifikues.

Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

7. Në tenderin me objekt: **“Rikonstruksion i objekteve rekreative”** me fond limit 8,238,410 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2017 dhe fitues shoqëria “S.” SHPK, me vlerë 8,196,921 lekë pa TVSH.

Në pikën 2.3/5 të DST, është kërkuar një inxhinier mekanik, kriter i pa nevojshëm, pasi referuar zërave të punimeve nuk ka punime që kërkohet prezenca e këtij inxhinieri.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se edhe OE i shpallur fitues “S.” SHPK, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, të miratuara nga AK, konkretisht:

- Subjekti “S.” SHPK, ka paraqitur kontratën nr.189/6 prot, datë 20.07.2015, të lidhur midis përfaqësuesit të “Njësisë Prodhuese HEC Fierz” dhe përfaqësuesit të OE “S.” SHPK, për objektin e prokurimit “Instalim I Sistemit të Ventilim-kondicionimi (HAVAC)”, nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

- Kontrata nr. .../6 prot, datë 03.07.2015, lidhur midis përfaqësuesit të “Njësisë Prodhuese HEC” dhe përfaqësuesit të OE “S.”, me objekt “Ndërtim dhe rrethim i territorit dhe ndriçimi I tij”, rezulton se shoqëria “S.” ka punësuar si nënkontraktor edhe OE “I.” por nuk specifikohet % e punës që do të kryej secili operator.

- Referuar preventivave përkatëse rezulton se shoqëria “S.”, nuk ka kryer punime druri etj.

Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

8.Në tenderin me objekt: **“Blerje drurë shkurre dhe lule”** me fond limit 6,639,583 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2017 dhe fitues shoqëria “A.” SHPK, me vlerë 6,535,930 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se OE “A.” SHPK i shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, pasi:

- Në sistem për tenderin me objekt "Blerje bimë dekorative, drurë shkurre ", viti 2017 me fond limit 6,639,583 lekë, në DST pika 2.3/a "Furnizime të ngjashme", nuk disponohet vërtetimi i lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e furnizimeve si dhe faturat tatimore të shitjes.

- Lidhur me licencën, Kodi III/7.A " Shërbime ekspertize dhe profesionale lidhur me pyjet dhe kullotat", shoqëria ka paraqitur Licencë me Kodin III/7.A me nr. LN-8214-07-2014, ku specifikohet se është i licencuar për "Shërbime profesionale për projekte dhe zbatime " dhe nuk ka lidhje me Licencën e kërkuar prej AK.

Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

9.Në tenderin me objekt: **“Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me Roje Private”** me fond limit 54,734,925 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2018 dhe fitues shoqëria “N.” SHPK, me vlerë 57,734,583 lekë pa TVSH.

Në aplikimin e specifikimeve teknike dhe kriteret kualifikuese, konstatohet se kriteret e aplikuar nga AK, nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, pasi janë të paargumentuara dhe të tepërta, konkretisht:

1.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

*3. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën **60 punonjës** shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë;*

Ky kriter është diskriminues, pasi subjekti mund ti ketë punonjësit e shërbimit me certifikata të lëshuara nga tjetër drejtori policie.

10.Në tenderin me objekt: **“Blerje autobot uji me agregat thithës, shtyrës, shpërndarës”** me fond limit 8,200,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqëria “P.” SHPK, me vlerë 8,150,000 lekë pa TVSH.

Në aplikimin e specifikimeve teknike dhe kriteret kualifikuese, konstatohet se kriteret e aplikuar nga AK, nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, pasi janë të paargumentuara dhe të tepërta, konkretisht:

3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001/2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Ky kriter është i panevojshëm, pasi nuk është në natyrën e objektit që prokurohet.

11.Në tenderin me objekt: **“Blerje pjesë këmbimi, goma, bateri dhe filtra”**, me fond limit 1,660,517 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqëria “B.” SHPK, me vlerë 1,270,000 lekë pa TVSH.

Në aplikimin e specifikimeve teknike dhe kriteret kualifikuese, konstatohet se kriteret e aplikuar nga AK, nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, pasi janë të paargumentuara dhe të tepërta, konkretisht:

*- Është i paargumentuar kriteri që subjekti duhet të paraqesë deklaratë doganore për mallrash sipas mjeteve që ka në dispozicion dhe deklarata doganore. **Deklarata doganore është e paargumentuar, pasi këtë akses e kanë vetëm subjektet importues dhe bën që në procedurë të marrin pjesë një numër i kufizuar subjektesh.***

- Është e paargumentuar pika e servisit. **Kriter i panevojshëm, pasi kemi të bëjmë me blerje mallrash dhe jo shërbime.**

- Është e paargumentuar kriteri që shoqëria të paraqes fletë doganore për të gjithë mallrat (gomat), ndërkohë që mund të kërkohet fletë doganore për gomat por jo specifikime për markën që do ofrohet (Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.3, faqet 50-88).

1.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për eliminimin e praktikave të konstatuara në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për aplikimin e kriterëve të paargumentuara me procedurën e prokurimit dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike për vlerën **183,894 mijë lekë** pa TVSH.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

1.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të Planit të veprimit, “Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH- së”, Njësia e Prokurimit ka mare argumentimit të kriterëve nga komisionet përkatëse të ngritura sipas urdhrat të titullarit, për procedurat e zhvilluar. Vlerësimi i kriterëve nga KVO i referohet kriterëve të vendosura në DST duke i pasqyruar në DST e publikuara në SPE.

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratave me objekt: “Rikonstruksioni i parqeve memoriale (ndërtim montim)”, me kolaudator shoqëria “P.” SHPK dhe kontrata me objekt: “Rehabilitimi i godinës së varrezave të dëshmorëve (Ndërtim – montim)” me kolaudator shoqëria “F.” SHPK, u konstatua se nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, nuk është zhvilluar procedurë prokurimi për përcaktimin e kolauduesit të objektit, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12. (Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.3.1, faqet 50-88).

2.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, në cilësinë e Nënpunësit Autorizues, të marrë masa për zhvillimin e procedurave të prokurimit në caktimin dhe lidhjen e kontratave të kolaudatorëve, për të gjitha punët publike që prokurohen dhe ndiqen nga ky institucion.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të Planit të veprimit, është parashikuar, miratuar dhe hedhur në regjistër dhe sistemin on-line të prokurimeve nga Autoriteti Kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit procedura e prokurimit me objekt Kolaudim dhe Mbikëqyrje punimesh për një sërë punësh, e cila është e ndarë në lote sipas secilit zë. Çdo procedure kolaudimi zhvillohet sipas legjislacionit në fuqi. Për zërat e regjistrit deri në 100 000 Lekë pa TVSH nuk zhvillohen procedurat e prokurimit referuar LPP dhe VKM për RRPP.

Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të blerjeve me vlera të vogla, u konstatua se:

Për periudhën objekt auditim (01.09.2017 – 31.12.2019), nga APR-ja janë zhvilluar në rrugë elektronike, gjithsej **25** procedura me fond limit 8,985 mijë lekë. Nga grupi i auditimit të KLSH-së, janë vlerësuar për auditim **18** procedura me vlerë të fondit 8,832 mijë lekë ose 98 % e fondit të planifikuar.

- Në të gjitha rastet e audituara me vlerë kontrate 8,832 mijë lekë, APR-ja ka përdorur vetëm një nga metodat për llogaritjen e fondit limit (*metoda e testimit të tregut*) dhe nuk ka përdorur metoda alternative, si atë të kontratave të ngjashme, kur një pjesë e mirë e procedurave janë të njëjtës natyrë dhe që zhvillohen çdo vit;

- Në të gjitha rastet e audituara me fond limit 8,832 mijë lekë, ofertat e paraqitura nga operatorët ku është bërë testimi i tregut, janë pa data të subjektit dhe nr. *prot* të APR, gjë e cila nuk vërteton se kur është testuar tregu, por vetëm me vulën dhe nënshkrimin e subjektit;

- Në të gjitha rastet e audituara me fond limit 8,832 mijë lekë, nuk është analizuar fakti, pse i njëjti subjektet paraqet çmime të ndryshme, midis çmimit të paraqitur në fazën e testimit të tregut dhe çmimit që paraqet në ofertën e pjesëmarrjes në tender.

- Në **7** raste me fond limit 3,861 mijë lekë ose 42.9 % e procedurave të zhvilluara, ofertat janë marrë nga të njëjtin OE, pa marrë parasysh faktin se kemi të bëjmë me Bashkinë Tiranë, ku numër i subjekteve që operojnë është shumë i lartë dhe mund të merren çmime më të leverdishme se ato të paraqitura nga po të njëjtin OE, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 1, neni 3/9, nenin 11, neni 23/4; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40 dhe neni 60-61; Udhëzimin e APP 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”; të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aseteve në sektorin publik” pika 35, 36, 37, 38, 42, 43 dhe 44,52,54. (*Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.2.4, faqe 38-46*).

3.1. Rekomandimi: Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, në përcaktimin e fondit limit të bëhet krahasimi i çmimeve me kontratat e mëparshme të ngjashme me ato të testimit të tregut, kjo për të mundësuar përcaktimin sa më afër realitetit të çmimeve për mallrat dhe shërbimet, si dhe të zgjerohet gama e subjekteve ku kryhen testimet për të marrë dhe të mos përqendrohen vetëm në disa subjekte.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të Planit të veprimit, “Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH- së”, Njësia e Prokurimit ka marrë argumentimit të kriterëve nga komisionet përkatëse të ngritura sipas urdhrit të titullarit, për procedurat e zhvilluar. Vlerësimi i kriterëve nga KVO i referohet kriterëve të vendosura në DST duke i pasqyruar në DST e publikuara në SPE. Gjithashtu për secilën procedure të zhvilluar janë hartuar relacionet përkatëse mbi përllogaritjen e fondit limit.

Zbatuar

C/III. MASA PËR TË RRIUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, u konstatua se:

- APR-ja ka trashëguar nga ish-komunat, gjithsej **128** kontrata me objekt: “*Dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor*”, për një sipërfaqe totale prej 434.181 ha dhe vlerë kontrate të lidhur prej 28,354,583 lekë.

Pas njoftimit të bërë nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, me shkresën nr. 1826*prot*, datë 16.11.2018 “Për njoftimin e subjekteve debitorë”, për likuidimin e vlerës së kontratave të qirasë, konstatohet se nga **128** kontrata me vlerë 28,354,583 lekë është mundësuar arkëtimi i **18** kontratave me vlerë **8,235,079 lekë**, duke mbetur për arkëtim **110** kontrata me vlerë **20,119,504 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e APR-^{së}, veprime në

kundërshtim me Urdhër nr. 381, datë 12.10.2018 “Për vijimin e procesit të likuidimit të detyrimeve financiare që rrjedhin nga kontratat e qirave”, nenet 689 e vijues të ligjit nr. 7854, datë 27.07.1994 për “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.

- Konstatohet se, kontratat e marra në administrim nga ish-komunat, sipas Urdhrit nr. 2188/1 *prot.*, datë 25.01.2017, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (*me procesverbalet*), rezultojnë se nuk kanë përmbushur qëllimi për të cilin janë lidhur, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” dhe ligjin nr. 7854 datë 27.07.1994 “Kodit Civil” të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, *pasi*:

a- Kanë një afat përdorimi mbi 10 vjet (*85 kontrata janë me afat 99 vite, 16 kontrata me afat 33 vite dhe 1 (një) kontratë me afat mbi 30 vite*), në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, lidhja nr. 2;

b-Tarifa vjetore të qirasë për ha/vit, janë llogaritur sipas Udhëzimit nr. 3, datë 16.05.2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe jo sipas VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”;

c- Nuk janë hartuar raporte tekniko-ekonomike të cilat duhet të ishin hartuar nga ish-DSHP Tiranë, ku të përcaktohej lloji i pyllit ose i bimësisë pyjore që shërben edhe si bazë për përlllogaritjen e çmimit të qirasë për ha/vit.

Gjithashtu, konstatohet se vlera e detyrimeve të paarkëtuara të 110 kontratave të qirave prej 20,119,504 lekë, nuk janë të regjistruara në kontabilitet në llog. 468 “*Debitorë*”, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; pika 1. Përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, standardet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4. (*Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.2.5, faqet 45-50*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave dhe Sektorin Juridik në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të paarkëtuara për **110** kontrata me vlerë **20,119,504 lekë**. (*Sipas pasqyrës përmbledhëse Aneks 3 bashkëlidhur Projekt Raportit dhe sipas tabelës së detajuar që disponon Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave*).

Të marrë masa për rishikimin e kontratave të lidhura nga ish- komunat në respektim të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 7854, datë 27.07.1994 “Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi kontratat e qirasë nuk kanë përmbushur qëllimin për të cilin janë lidhur.

Lidhja e kontratave të reja të bëhet sipas formës së kontratës TIP të miratuar nga Ministria e Mjedisit

1.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në APR, të marrë masa për kontabilizimin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore që rrjedhin nga kontratat e pyjeve dhe kullotave të trashëguara nga ish- komunat në shumën 20,119,504 lekë.

Brenda datës 31.12.2020

1.3. Nga verifikimi rezultoi se: *Me Urdhër nr. 132, datë 25.03.2021 “Për marrjen e masave për zbatimin e rekomadimeve të raportit përfundimtar të auditimit, Kontrollit të Lartë të Shtetit, për arkëtimin e detyrimeve nga qiradhënie, rishikimin e kontratave të qerave të lidhura për fondin pyjor nga ish-komuna dhe lidhjen e kontratave të reja sipas formës së kontratës TIP”.*

(Bashkëlidhur tabela e kontratave të rishikuara)

*Me Urdhër nr. 138, datë 29.03.2021 është ngritur grupi i punës për “hartimin e raporteve mbi studimet tekniko-ekonomike për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullësor në pronësi të Bashkisë Tiranë” Në vijim të punës së bërë nga APR është bërë e mundur arkëtimi i vlerë totale **17,646,951 lekë** duke ngelur pa u arkëtuar dhe vlera **2,472,553 lekë**. (Bashkëlidhur tabela aneks)*

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, gjatë ushtrimit të detyrave të ngarkuara nga VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit”, ka evidentuar sipërfaqe të cilat shfrytëzohen nga individ dhe subjekte, pa lidhur kontratë qiraje me APR, ku janë evidentuar gjithsej **188** ngastra me një sipërfaqe totale prej **692 ha**, në zonat kadastrale (ZK) që disponon Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave. Pavarësisht faktit se këto prona janë në administrim të APR, ato janë në përdorim nga persona të tretë për përfitime individuale, duke çuar në mungesë të të ardhurave për APR në vlerën prej **25,206,000 lekë**, nga mos lidhja e kontratave dhe llogaritja e detyrimit për qiranë në zbatim të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

Konstatohet se, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave edhe pse ka evidentuar sipërfaqe të zaptuara nga të tretë dhe pa kontrata individuale, nuk janë kryer veprime të tjera ligjore për detyrimin e personave në lidhjen e kontratave të qirasë për sipërfaqet që ato kanë në përdorim, veprime në kundërshtim me shkronjën (b), pika 2, e nenit 17 dhe pika 1, të nenit 25 të ligjin nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”; Rregulloren e Brendshme nr. 1055/1, datë 28.06.2019 të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë; Ligjit nr. 48/2016, datë 05.05.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”; VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike”; Urdhrit nr. 2188/1 prot, datë 25.01.2017, i Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Gjithashtu, këto sipërfaqe janë të mbjella me kultura disa vjeçare dhe ndodhen në fazën e prodhimit, por për shkak të terrenit të vështirë nuk është bërë i mundur evidentimi në mënyrë të detajuar (*gjeneralitetet e poseduesit, sipërfaqe e zënë, lloji i kulturave të mbjella*), si dhe i sipërfaqeve pyjore të cilave ju është ndryshuar destinacionit. (*Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.2.5, faqet 45-50*).

2.1. Rekomandimi: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialit të fushës së Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, ku të bëhet evidentimi në mënyrë të detajuar i sipërfaqeve të zaptuara nga të tretë dhe lloji i kulturave të mbjella me qëllim lidhjen e kontratave të qirasë për sipërfaqet që subjektet kanë në përdorim, për të shmangur mungesën e të ardhurave në vlerën **25,206,000 lekë**, nga mos llogaritja e detyrimit në zbatim të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

Për subjektet të cilat refuzojnë lidhjen e kontratës së qirasë, por që vazhdojnë të posedojnë pronën në kundërshtim me ligjin nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të merren masa konkrete duke i referuar në organet e prokurorisë për veprën penale “*Pushtimi i tokës*”, parashikuar nga neni 200 të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime

Deri me datë 31.01.2021.

2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nëpunësi Autorizues me Urdhër nr. 133, datë 25.03.2021 “Për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit, është ngritur “Komisioni për evidentimin e sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullësor të zëna

nga të tretët dhe lidhjen e kontratave të qirave” dhe me urdhrin nr. 138, datë 29.03.2021 janë ngritur grupet e punës “Për hartimin e raporteve mbi studimet tekniko-ekonomike për dhënie në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullësor në pronësi të Bashkisë Tiranë”.

(Bashkëlidhur tabela e kontratave të lidhura për sipërfaqet e zaptuara)

Në proces zbatimi

D. MASA ADMINISTRATIVE

D/I. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet nr. 1, 12, 13, 14, 15, 16 datë 12.06.2020, nr. 19 dhe 20, datë 30.06.2020, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar trajtuar në Kap III/2.3, faqe 50-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenet 15 shkronja (c, ç) dhe neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **20 (njëzet) punonjës dhe ish-punonjës.**

Nga verifikimi rezultoi se Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar APP marrjen e masës administrative me gjobë për 20 persona. APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur marrjen e masës administrative me gjobë për 26 persona në vlerë totale 1.620.000 leke dhe masë disiplinore për 5 persona. Në zbatim të rekomandimeve ka dal urdhri nr. 09. date 12.01.2022, prot 45 date 12.01.2022 për “Marrjen e masave për zbatimin e vendimit të APP-së nr. 54, date 22.06.2021, nga ku rezulton se deri në momentin e verifikimit, ka filluar ndalesa për mbajtjen nga paga 9 punonjës në vlerën 540,000 lekë, ndodhet në proces gjyqësorë 10 persona në vlerën 620,000 lekë si dhe nuk është kryer asnjë procedurë për 7 persona në vlerën 460,000 lekë për të cilat KLSH rikërkon zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara. Në mënyrë të detajuar masat e rekomanduara nga KLSH paraqiten si vijon:

D/2 Masat e rekomanduara nga KLSH

1. z. B. H., me funksion ish- Zv/Drejtor i Përgjithshëm (periudha 10.12.2019 – 10.02.2020). Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur dënimin më gjobë në vlerën 60.000 lekë. Deri në momentin e verifikimit nuk është kryer asnjë procedurë tjetër në zbatim të vendimit të APP

2. z. A. Z., me funksion Përgjegjës Sektori në Drejtorinë Teknike dhe Operacional, në cilësinë e Kryetarit të grupit të punës për hartimin e DST-^{ve}. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur të dënojë më gjobë në vlerën 100.000 lekë. Me urdhrin nr. 09 datë 12.01.2022 është bërë ndalesa e pjesshme e pagesës sipas marrëveshjes.

3. zj. G. Ç., me funksionspecialist në Njësinë e Prokurimit Publik. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur të dënojë më gjobë në vlerën 100.000 lekë dhe aktualisht ndodhet në proces gjyqësorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me nr. çështje 31137-05028-080-2021.

- 4. z. M. K.,** me funksion Përgjegjës i Sektori Ideim, Projektimi. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 80.000 lekë dhe aktualisht ndodhet në proces gjyqësorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me nr. çështje 31137-05028-080-2021.
- 5. zj. R. Ç.,** me funksion specialist në Drejtorinë e Projektim dhe Zhvillimit. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 80.000 lekë. Deri në momentin e verifikimit nuk është kryer asnjë procedurë tjetër në zbatim të vendimit të APP.
- 6. zj. V. H.,** me funksion Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë Ekonomike. Përrjashtuar nga APP ne vendimin 57 datë 22.06.2021.
- 7.z. Q. V.,** me funksion Përgjegjës Sektori në Drejtorinë Teknike dhe Operacional. Përrjashtuar nga APP ne vendimin 57 datë 22.06.2021.
- 8. z. G. L.,** me funksion Specialist në Drejtorinë e Projektim Zhvillimit. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 80.000 lekë dhe aktualisht ndodhet në proces gjyqësorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me nr. çështje 31137-05028-080-2021.
- 9. z. D. L.,** me funksion ish-Drejtor Drejtorie. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 50.000 lekë dhe aktualisht ndodhet në proces gjyqësorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me nr. çështje 31137-05028-080-2021.
- 10. zj. E. L.,** me funksion Specialiste në Drejtorinë e Projektim dhe Zhvillimit. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 60.000 lekë. Me urdhrin nr. 09 datë 12.01.2022 është bërë ndalesa e pjeshme e pagesës sipas marrëveshjes.
- 11. zj. S. L.,** me funksion Specialiste në Drejtorinë e Projektim dhe Zhvillimit. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 60.000 lekë dhe aktualisht ndodhet në proces gjyqësorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me nr. çështje 31137-05028-080-2021.
- 12. z. L. P.,** me funksion Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 50.000 lekë. Me urdhrin nr. 09 datë 12.01.2022 është bërë ndalesa e pjeshme e pagesës sipas marrëveshjes
- 13. z. G. H.,** me funksion Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Gjellbërimit Dekorativ. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 50.000 lekë. Me urdhrin nr. 09 datë 12.01.2022 është bërë ndalesa e pjeshme e pagesës sipas marrëveshjes.
- 14. zj. E. S.,** me funksion Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore. Përrjashtuar nga APP ne vendimin 57 datë 22.06.2021.
- 15.zj. M. C.,** me funksion specialist në Drejtorinë Teknike dhe Operacional. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 80.000 lekë. Deri në momentin e verifikimit nuk është kryer asnjë procedurë tjetër në zbatim të vendimit të APP.
- 16. zj. G. V.,** me funksion Drejtor i Njësisë së Prokurimit. Përrjashtuar nga APP ne vendimin 57 datë 22.06.2021.
- 17. z. F. P.,** me funksion specialist në Njësinë Luaj Tirana, në cilësinë e Kryetarit të grupit të punës për hartimin e DST-^{ve}. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 70.000 lekë. Me vendimin nr. 75, datë 21.01.2022 Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është vendosur shfuqizimi i Vendimit të APP.
- 18. z. Q. Z.,** me funksion Përgjegjës sektori në Drejtorinë e Gjellbërimit Dekorativ. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më

gjobë në vlerën 70.000 lekë. Me urdhrin nr. 09 datë 12.01.2022 është bërë ndalesa e pjesshme e pagesës sipas marrëveshjes

19. zj. S. G., me funksion specialist në Drejtorinë e Gjelbërimit Dekorativ, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e DST^{ve}. *Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 70.000 lekë. Me urdhrin nr. 09 datë 12.01.2022 është bërë ndalesa e pjesshme e pagesës sipas marrëveshjes*

20. z.M. M., me funksion ish-Zv/Drejtor i Përgjithshëm, periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. *Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 60.000 lekë. Deri në momentin e verifikimit nuk është kryer asnjë procedurë tjetër në zbatim të vendimit të APP*

Ne Vendimin e APP-së nr. 57 datë 22.06.2021 janë shtuar dhe emrat si me poshtë:

1. z. B. I., me funksion teknik i mesëm, në Drejtorinë teknike dhe operacionale periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. *Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 30.000 lekë. Me urdhrin nr. 09 datë 12.01.2022 është bërë ndalesa e pjesshme e pagesës sipas marrëveshjes*

2. zj. A. M., me funksion specialiste në Drejtorinë e projektim zhvillimit, periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. *Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 60.000 lekë dhe aktualisht ndodhet në proces gjyqësorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me nr. çështje 31137-05028-080-2021.*

3. zj. D. L., me funksion përgjegjëse sektori në drejtorinë e projektim zhvillimit 23.01.2019 – 15.01.2020. *Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 60.000 lekë. Me urdhrin nr. 09 datë 12.01.2022 është bërë ndalesa e pjesshme e pagesës sipas marrëveshjes.*

4. z. B. S., me funksion ish-Zv/Drejtor i Përgjithshëm, periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. *Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 40.000 lekë. Deri në momentin e verifikimit nuk është kryer asnjë procedurë tjetër në zbatim të vendimit të APP*

5. z. I. M., me funksion ish-Zv/Drejtor i Përgjithshëm, periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. *Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 50.000 lekë dhe aktualisht ndodhet në proces gjyqësorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me nr. çështje 31137-05028-080-2021.*

6. zj. S. D., me funksion përgjegjëse sektori në drejtorinë e projektim zhvillimit periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. *Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 50.000 lekë dhe aktualisht ndodhet në proces gjyqësorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me nr. çështje 31137-05028-080-2021.*

7. zj. J. J., me funksion specialiste në Drejtorinë e projektim zhvillimit, periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. *Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 50.000 lekë dhe aktualisht ndodhet në proces gjyqësorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me nr. çështje 31137-05028-080-2021.*

8. z. D. A., me funksion ish-Zv/Drejtor i Përgjithshëm, periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. *Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 50.000 lekë dhe aktualisht ndodhet në proces gjyqësorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me nr. çështje 31137-05028-080-2021.*

9. zj. A. H., me funksion specialiste në Drejtorinë e gjelbërimit dekorativ, periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. *Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë*

22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 50.000 lekë. Me urdhrin nr. 09 datë 12.01.2022 është bërë ndalesa e pjeseshme e pagesës sipas marrëveshjes

10. zj. S. L., me funksion specialiste në Drejtorinë e projektim zhvillimit, periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në valëtën 60.000 lekë. *Deri në momentin e verifikimit nuk është kryer asnjë procedurë tjetër në zbatim të vendimit të APP*

11.z. E. G., me funksion specialiste në Drejtorinë e administrimit te pyjeve dhe kullotave, periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka propozuar Titullarit për mase disiplinore. Me urdhrin nr. 463 datë 30.09.2021 është vendosur masë disiplinore.

12.zj. E. D., me funksion specialiste në Drejtorinë e administrimit te pyjeve dhe kullotave 23.01.2019 – 15.01.2020. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka propozuar Titullarit për mase disiplinore. Me urdhrin nr. 464 datë 30.09.2021 është vendosur masë disiplinore.

13.z. E. B., me funksion magazinier në Drejtorinë e administrimit te pyjeve dhe kullotave 23.01.2019 – 15.01.2020. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka propozuar Titullarit për mase disiplinore.

14.zj. Y. Q., me funksion përgjegjëse sektori në drejtorinë e aktiviteteve rekreative, 23.01.2019 – 15.01.2020. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka propozuar Titullarit për mase disiplinore. Me urdhrin nr. 460 datë 30.09.2021 është vendosur masë disiplinore.

15.z. E. B., me funksion specialist në drejtorinë e aktiviteteve rekreative 23.01.2019 – 15.01.2020. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka propozuar Titullarit për mase disiplinore. Me urdhrin nr. 461 datë 30.09.2021 është vendosur masë disiplinore.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me emailin e datës 01.09.2022, nga z. J. T. në cilësinë e Drejtorit Juridik, protokolluar në KLSH me nr.445/. datë 01.09.2022, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Observacion i Subjektit të Audituar: - Në lidhje me gjetjen e sipërcituar sqarojmë se, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit në zbatim të Vendimit nr. 57, date 22.06.2021 të APP-së ka filluar ndalesat për mbajtjen nga paga të gjobës së vendosur.

Përsa i përket znj. S. L., me funksion specialist në Drejtorinë Projektim Zhvillim, ju bëjmë me dije se nuk është filluar asnjë procedurë pasi specialistja në fjalë ka nisur procesin gjyqësor, kundër masës së vendosur nga APP-ja.

Përsa i përket personave të tjerë, konkretisht z. B. H., z. M. K., znj. R. Ç., znj. M. C., z. M. M. dhe z. B. S., për të cilët nuk është filluar asnjë procedurë, ju bëjmë me dije se këta persona nuk janë pjesë e administrates së Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit.

Sa i takon zbatimin të Vendimit nr. 57, date 22.06.2021, të Agjencisë së Prokurimit Publik për personat e sipërcituar (ish punonjës të APR-së), sqarojmë se ky vendim është një akt administrativ cili përmban dënime administrative, të cilat krijojnë pasoja juridike për personat përkatës. Si i tillë ekzekutimi i këtij vendimi kryhet në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”.

Duke qenë se ka persona aktualisht nuk janë në marrdhënie pune me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, vjelja e gjobave të parashikuara në vendimin nr. 57, datë 22.06.2021, nga këta persona duhet të kryhet nëpërmjet shërbimit përmbartimor, në përputhje me rregullat e përcaktuara në kreun V, të Ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative” dhe nenin 510 e vijues, të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Vendimi nr. 57, datë 22.06.2021, është titull ekzekutiv në kuptim të neneve 20 dhe 22 të Ligjit “Për kundravajtjet administrative”, për shkak se parashikon dënimin me gjobë ndaj disa personave, të cilët referuar pjesës arsytuese të këtij kanë kryer kundravajtje administrative

në fushën e prokurimit publik. Si i tillë ky vendim vihet në ekzekutim të detyrueshëm nëpërmjet lëshimit paraprakisht të urdhërit ekzekutimit nga gjykata kompetente, në përputhje me nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile.

Ligji “Për kundravajtjet administrative”, nënin 5, ka përcaktuar se vendimi për kundravajtjen administrative bëhet i ekzekutueshëm nga **organi administrativ që e ka nxjerrë atë**. Gjithashtu në lidhje me mënyrën e ekzekutimit të vendimit të kundravajtjes administrative dhe procedurën e nxjerrjes së urdhërit ekzekutimit nga gjykata, ligji në pikën 4, të nenit 30, kreu V, ka përcaktuar se kërkesa për nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit bëhet në gjykatë nga **titullari i organit që ka nxjerrë vendimin për kundravajtjen administrative**.

Në rastin konkret, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit pavarësisht së ngarkohet nga Ligji “Për prokurimin publik” për vjeljen e gjobave të përcaktuara në vendimin nr. 57, datë 22.06.2021, nuk legjitimohet për të paraqitur kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në gjykatën kompetente për ish-punonjësit, pasi organi i cili ka nxjerrë këtë vendim është Agjencia e Prokurimit Publik, e cila referuar nenit 5 dhe pikës 4 të nenit 30, të Ligjit “Për kundravajtjet administrative” është i vetmi organ (palë) që legjitimohet për paraqitjen e kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për vendimin nr. 57, datë 22.06.2021.

Lidhur sa më sipër, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për vjeljen e gjobave të përcaktuara vendimin nr. 57, datë 22.06.2021, nga ish-punonjësit e saj për shkak se referuar parashikimeve të Ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, nuk legjitimohet për paraqitjen e kërkesës në gjykatën kompetente për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, referuar znj. S. L., me funksion specialist në Drejtorinë Projektim Zhvillim, do të meret në konsiderat dhe do të reflektohet në masat e rikërkuar pasi aktualisht është në proces gjyqësor, kundër masës së vendosur nga APP-ja.

Persa i përket personave të tjerë, konkretisht: z. B. H., z. M. K., znj. **R. Ç.**, znj. **M. C.**, z. **M. M.** dhe z. B. S. pretendimet e sipërcituara nuk meren në konsiderate, pasi referuar Kreu XI “Sanksionet Administrative dhe Masat Disiplinore” neni 79 pika 4 ngarkon Autoriteti kontraktor përkatës për vjeljen e gjobave të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni.

D/II. Për Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Tiranë.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e zbatimit të punimeve publike të ndërtimit dhe në zbatim të nenit 7 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, si dhe bazuar në nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Tiranë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative (gjobë) për 1 (një) mbikëqyrës, si më poshtë:**

I.z. A. L., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të kontratës nr. 818/8 prot, datë 22.06.2017. Për shkeljen e konstatuar në objektin: “Rikonstruksioni i amfiteatrit”, Bashkia Tiranë, me sipërmarrës punimesh shoqërinë “F.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **863,698 lekë** pa TVSH, si diferencë në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt. *(Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.3.1, faqe 88-96)*

Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar

Pa zbatuar

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me emailin e datës 01.09.2022, nga z. J. T. në cilësinë e Drejtorit Juridik, protokolluar në KLSH me nr.445/.. datë 01.09.2022, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Observacion i Subjektit të Audituar: Në lidhje me gjetjen e sipërcituar sqarojmë se, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit i është drejtuar Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 1974 prot, date 05.08.2022 me lëndë “Dërgim raporti auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nëpërmjet të cilës ka kërkuar vlerësimin rekomandimit të lënë në raportin përfundimtar të auditimit, në lidhje me shkeljen e kryer nga z. A. L., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të kontratës nr. 818/8 prot, datë 22.06.2017, me objekt “Rikonstruksion i Amfitetatrit”.

Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) Bashkia Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. 7035/1, datë 23.08.2022 (protokolluar pranë Agjencisë me nr. 1974/1 prot., datë 24.08.2022), ka sqaruar se marrja e masës administrative (gjobë) ndaj z. A. L. në cilësinë e mbikëqyrësit, nuk hyn në kompetencat e IMT Bashkia Tiranë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

E. MASA DISIPLINORE:

E/1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me “Kodin e Punës”:

Për të gjithë punonjësit, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe anekset bashkëlidhur, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tiranë**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për periudhën 01.09.2017 deri më 31.12.2019, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37, të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe germa (b) e nenit 9, të kontratës individuale, marrjen e masës për **4 (katër)** punonjës, si më poshtë:

1. z. R. Ç., me funksion Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave. Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 549, datë 31.12.2021 është dhënë masa disiplinore “vërejtje”, ndaj punonjësit R. Ç., me funksion Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave. *Me urdhrin nr. 549 datë 31.12.2021 është vendosur masë disiplinore.*

2. zj. M. L., me funksion specialist në Sektorin e Njesisë së Prokurimeve (profili juriste). Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 550, datë 31.12.2021 është dhënë masa disiplinore “vërejtje”, ndaj punonjësit Malvina Lleshi, me funksion me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve. *Me urdhrin nr. 550 datë 31.12.2021 është vendosur masë disiplinore.*

3. zj. G. Ç., me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve (profili fakulteti agronomi). Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 551, datë 31.12.2021 është dhënë masa disiplinore “vërejtje”, ndaj punonjësit G. Ç., me funksion me funksion specialist në Njësinë e Prokurimeve. *Me urdhrin nr. 551 datë 31.12.2021 është vendosur masë disiplinore.*

4. zj. A. B., me funksion specialist në Njësinë e Prokurimit (fakulteti gjuhë/letërsi). Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 552, datë 31.12.2021 është dhënë masa disiplinore “vërejtje” ndaj punonjësit A. B., me funksion me funksion specialist

në Njësinë e Prokurimeve. Me urdhrin nr. 552 datë 31.12.2021 është vendosur masë disiplinore.

Zbatimi i rekomandimeve për APR sipas (Formulari nr. 12):

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit nw %	Statusi i rekomandimeve te pranuar									
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera		Zbatuar		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
									Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	4		4				100	4									
2	Masa shpërblim dëmi	2	1,447	2	1,447			100			1	584					1	863
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	3	183,894	3	183,894			100	2		1	183,894						
4	Mungesë të ardhurat	2	45,325	2	45,325			100			2	45,325	17,646	27,679				
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
5	Masa disiplinore	4		4				100	4									
	<i>-Me Status Nënpunësi Civil</i>																	
	<i>-Me kontratë punë</i>	4		4				100	4									
6	Masa Administrative	32	0	32	0	0	0	100	5	0	9	540	0	0	8	460	10	620
	<i>-Nga APP</i>	31		31					5		9	540			7	460	10	620
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
	<i>-Nga IMTV</i>	1		1				100							1			
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
11	Tjera																	
	TOTALI	47	230,666	47	230,666	0	0	600	15	0	13	230,343	17,646	27,679	8	460	11	1,483

Burimi: Grupi i auditimit i KLSH-së

IV- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të auditimit Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 328/7 prot, datë 09.03.2021, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre është e pazbatuar, duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

C/I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH-së* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe pikën 93, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (*Padi gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nënpunësi Zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,447,958 lekë**, si më poshtë:

KLSH për masat shpërblim dëmi, i ka rekomanduar **Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit** 2 masa me vlerë **1,447,958 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht dhe deri me datë 20.05.2022, është në proces gjyqësor 1 masë në vlerën **863,698 lekë**, ndërsa për 1

rekomandim janë nisur njoftimet dhe ende nuk ka filluar arkëtimi i vlerës prej **584,260 lekë**, si vijon:

1. Gjetje nga auditimi: (*Sipas pikës nr. 2 masa shpërblim dëmi*) Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “*Rikonstruksioni i parqeve memoriale (ndërtim/montim)*”, me vlerë 14,023,115 lekë dhe kontraktues shoqërinë “L.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **584,260 lekë pa TVSH**, konkretisht në zërat e punimeve “*FV hekur betoni*”, “*Shtresë betoni C12/15*”, “*Veshje muri me pllaka guri të skalitur*” dhe “*Restaurim i shtresës me pllaka guri*”, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. .../11 prot, datë 29.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor dhe shoqërisë “L.” SHPK. (*Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.3.1, faqet 88-96*).

1.1. Rekomandimi: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për shpërblim dëmi në vlerën **584,260 lekë pa TVSH** nga shoqëria “L.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës nr. .../11prot, datë 29.07.2019, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

1.2. Rekomandim mbas verifikimit:

Nga ana e Drejtorit të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, të nxirret urdhër zhdëmtimi për vlerën e dëmit prej 584,260 lekë ndaj OE “L.” SHPK, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtim.

Menjëherë

C/II. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi 01.09.2017 – 31.12.2019 nga subjekti Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, janë zhvilluar gjithsej **93** procedura prokurime me fond limit 492,124 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate prej 463,885 mijë lekë pa TVSH.

Mbi bazën e materialitetit dhe riskut janë vlerësuar për auditim **44** procedura me vlerë kontrate 363,846 mijë lekë pa TVSH, nga ku kanë rezultuar me shkelje **11** procedura me vlerë kontrate 183,894 mijë lekë pa TVSH ose 50.5% e procedurave të audituara, pasi për **3** procedura disa nga kriteret e vendosura në DST, të hartuara nga Njësia e Prokurimit dhe të miratuara nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës (*zërat e preventivave*), veprime të cilat direkt ose indirekt eliminojnë mos pjesëmarrjen e Operatorët Ekonomik (OE) në garë ose janë kriteret për skualifikim të OE pjesëmarrës, ndërsa në **8** procedura OE/BOE janë shpallur fitues dhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të hartuara nga NjHDT dhe të miratuara nga Titullari i AK, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të DST, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **183,894 mijë lekë pa TVSH**, nga e cila për vitin buxhetor raportues 2019 në vlerën 116,123 mijë lekë dhe për periudhës para vitit buxhetor 2019 (pra 2017 – 2018), në vlerën 67,771 mijë lekë, në kundërshtim me nenin 2 “*Parimet e përzgjedhjes*”, nenin 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*”, pika 2, nenin 24 “*Anulimi i një procedure prokurimi*”, nenin 53 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, dhe nenin 66 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, *konkretisht rastet:*

1. Në tenderin me objekt: **“Rikonstruksion i parqeve memoriale (Ndërtim Montim)”**, me fond limit 15,579,200 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqërinë “L.” SHPK, me vlerë 11,685,929 lekë pa TVSH.

Në vendosjen e kriterëve, konstatohet se nga AK janë kërkuar kriterë të paargumentuara, konkretisht:

- *“Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçencë Profesionale të shoqërisë, për restaurimin e monumenteve të arkitekturës.*

- *CZ – Zbatim për punimet e restaurimit të monumenteve të arkitekturës”.*

Nisur nga zërat e preventivit të punimeve, të dy këto kriterë janë të paargumentuar teknikisht dhe nuk duhej vendosur.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se OE i shpallur fitues “L.” SHPK, ka rezultuar se në dokumentacionin e paraqitur për automjetin “Eskalator mungon”, leja e qarkullimit nuk është paraqitur, duke mos plotësuar kriterin 8/a.

Në kontratat e bëra për marrjen me qira të mjeteve, në asnjë kontratë nuk është specifikuar objekti i prokuruar, duke mos plotësuar kriterin 8/c. Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

2. Në tenderin me objekt: **“Shërbime të tjera, prodhim i lëndës drusore”**, me fond limit 33,332,830 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqërinë “A.” SHPK, me vlerë 33,312,951 lekë pa TVSH.

Nga auditim i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se OE i shpallur fitues “A.” SHPK, nuk plotëson të gjithë kërkesat e DST të miratuara nga AK, konkretisht: 1- Mungon bilanci 2018, në kundërshtim me pikën 3.2.1 të KVK;

- *Nuk është e përcaktuar në dokumentacionin e paraqitur, që disponohen mjete transporti dhe financiare për të shfrytëzuar jo më pak se 5000 m³ lëndë drusore në vit, në kundërshtim me pikën 3.3.3 të KVK ;*

- *Punëtorët janë të certifikuar nga vetë shoqëria, në kundërshtim me pikën 3.3.6 të KVK.*

Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

3. Në tenderin me objekt: **“Blerje Karburanti”**, me fond limit 48,328,077 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues BOE “A. & O.” SHPK, me vlerë 48,328,077 lekë pa TVSH.

Nga auditim i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se BOE i shpallur fitues “A.” SHPK, nuk plotëson kriterin 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 11.

BOE ka paraqitur një dokument i quajtur “Faqja e Menaxhimit të Karburanteve”, i cili është një dokument vetëm me logon e shoqërisë “B.” dhe të shoqërisë “O.” SHPK, por jo kontratë e nënshkruar nga palët. Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

4. Në tenderin me objekt: **“Rehabilitimi i godinës së Varrezave të dëshmorëve (Ndërtim Montim)”**, me fond limit 5,691,299 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqëria “V.” SHPK, me vlerë 5,405,212 lekë pa TVSH.

Mbi përcaktimin kriterëve të kualifikimit:

- *Nisur edhe nga zërat e përfshira në preventivin e punimeve, rezulton që kriteri për punësimin e një arkitekti, të jetë i paargumentuar teknikisht dhe për pasojë nuk duhej vendosur.*

- *Nisur nga volumet e preventivit dhe zërat e punës, kërkesa për “Sharrë për prerje guri”, “Rrol për shtresat, kapaciteti 4 ton”, “Autobetonjere + pompë betoni” dhe “Makineri e lëvizshme me pajisje speciale për testimin e materialeve të ndërtimit”, janë të paargumentuara teknikisht dhe për pasojë nuk duheshin vendosur.*

Mbi vlerësimin e ofertave.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë në pjesë 3 OE, nga të cilët janë kualifikuar 2 dhe janë skualifikuar 1 OE.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se OE i shpallur fitues "V." SHPK, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, të miratuara nga AK, konkretisht:

- Dokumentacioni i paraqitur për "Makineri e lëvizshme me pajisje speciale për testimin e materialeve të ndërtimit" është për automjetin tip "Iveco 49 E 12", i cili është mjet që regjistrohet në regjistrat publikë. Për këtë mjet është paraqitur kontrata me shoqërinë "F." SHPK me nr. 2146 rep, datë 30.05.2019 dhe deklarata doganore për mjetin, por nuk paraqiten dokumentet e kërkuara në KVK si më poshtë: "Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni e mjetit (të vlefshme) dhe lejen e transportit, dhe për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni e mjetit dhe lejen e transportit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi".

- Për inxhinieren e mjedisit Artenisa Baku, nuk është paraqitur certifikata e lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

5. Në tenderin me objekt: "**Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative (materiale reaktive, banera, instilacione, kupa, medalje)**", me fond limit 831,340 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqëria "B." SHPK, me vlerë 830,000lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se OE i shpallur fitues "B." SHPK, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, të miratuara nga AK, konkretisht:

- Nuk plotëson pikën 3.2.5 të DST, pasi certifikata e paraqitur ISO EN 3834-05, nuk është sipas modelit të kërkuar në DST, e cila duhej ISO EN 3834-2015, si dhe emërtimi që kërkohet (për arredim indorr...).

Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

6. Në tenderin me objekt: "**Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike**", me fond limit 2,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqërinë "Z." SHPK, me vlerë kontrate 2,444,444 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se edhe OE i shpallur fitues "E." SHPK, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, të miratuara nga AK, konkretisht:

- Nuk plotëson pikën 2.2.1 të DST, ku kërkohet paraqitja e pasqyrave financiare të certifikuarra për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Nga shoqëria është paraqitur me certifikatë vetëm pasqyrat e vitit 2016, ndërsa vitet 105 dhe 2017 nuk kanë raport certifikimi.

- Nuk plotësohet pika 2.12 e DST, ku kërkohet 3 punonjës të siguruar si montues. Nga shoqëria vetëm është deklaruar fakti se ka punonjës montues, por nuk ka të evidentuar emrat e tyre dhe dokumentacioni justifikues.

Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

7. Në tenderin me objekt: "**Rikonstruksion i objekteve rekreative**" me fond limit 8,238,410 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2017 dhe fitues shoqëria "S." SHPK, me vlerë 8,196,921 lekë pa TVSH.

Në pikën 2.3/5 të DST, është kërkuar një inxhinier mekanik, kriter i pa nevojshëm, pasi referuar zërave të punimeve nuk ka punime që kërkohet prezenca e këtij inxhinieri.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se edhe OE i shpallur fitues "S." SHPK, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, të miratuara nga AK, konkretisht:

- Subjekti "S." SHPK, ka paraqitur kontratën nr.189/6 prot, datë 20.07.2015, të lidhur midis përfaqësuesit të "Njësisë Prodhuese HEC Fierz" dhe përfaqësuesit të OE "S." SHPK, për

objektin e prokurimit “Instalim I Sistemit të Ventilim-kondicionimi (HAVAC)”, nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

- Kontrata nr. 188/6 prot, datë 03.07.2015, lidhur midis përfaqësuesit të “Njësisë Prodhuese HEC” dhe përfaqësuesit të OE “S.”, me objekt “Ndërtim dhe rrethim i territorit dhe ndriçimi I tij”, rezulton se shoqëria “S.” ka punësuar si nënkontraktor edhe OE “I.” por nuk specifikohet % e punës që do të kryej secili operator.

- Referuar preventivave përkatëse rezulton se shoqëria “S.”, nuk ka kryer punime druri etj. Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

8.Në tenderin me objekt: “**Blerje drurë shkurre dhe lule**” me fond limit 6,639,583 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2017 dhe fitues shoqëria “A.” SHPK, me vlerë 6,535,930 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, konstatohet se OE “A.” SHPK i shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, pasi:

- Në sistem për tenderin me objekt “Blerje bimë dekorative, drurë shkurre”, viti 2017 me fond limit 6,639,583 lekë, në DST pika 2.3/a “Furnizime të ngjashme”, nuk disponohet vërtetimi i lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e furnizimeve si dhe faturat tatimore të shitjes.

- Lidhur me licencën, Kodi III/7.A “Shërbime ekspertize dhe profesionale lidhur me pyjet dhe kullotat”, shoqëria ka paraqitur Licencë me Kodin III/7.A me nr. LN-8214-07-2014, ku specifikohet se është i licencuar për “Shërbime profesionale për projektme dhe zbatime” dhe nuk ka lidhje me Licencën e kërkuar prej AK.

Në këto kushte procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re.

9.Në tenderin me objekt: “**Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me Roje Private**” me fond limit 54,734,925 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2018 dhe fitues shoqëria “N.” SHPK, me vlerë 57,734,583 lekë pa TVSH.

Në aplikimin e specifikimeve teknike dhe kriteret kualifikuese, konstatohet se kriteret e aplikuar nga AK, nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, pasi janë të paargumentuara dhe të tepërta, konkretisht:

1.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

3. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën **60 punonjës** shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë;

Ky kriter është diskriminues, pasi subjekti mund ti ketë punonjësit e shërbimit me certifikata të lëshuara nga tjetër drejtori policie.

10.Në tenderin me objekt: “**Blerje autobot uji me agregat thithës, shtyrës, shpërndarës**” me fond limit 8,200,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqëria “P.” SHPK, me vlerë 8,150,000 lekë pa TVSH.

Në aplikimin e specifikimeve teknike dhe kriteret kualifikuese, konstatohet se kriteret e aplikuar nga AK, nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, pasi janë të paargumentuara dhe të tepërta, konkretisht:

3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001/2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Ky kriter është i panevojshëm, pasi nuk është në natyrën e objektit që prokurohet.

11.Në tenderin me objekt: “**Blerje pjesë këmbimi, goma, bateri dhe filtra**”, me fond limit 1,660,517 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019 dhe fitues shoqëria “**B.**” SHPK, me vlerë 1,270,000 lekë pa TVSH.

Në aplikimin e specifikimeve teknike dhe kriteret kualifikuese, konstatohet se kriteret e aplikuar nga AK, nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, pasi janë të paargumentuara dhe të tepërta, konkretisht:

- *Është i paargumentuar kriteri që subjekti duhet të paraqesë deklaratë doganore për mallrash sipas mjeteve që ka në dispozicion dhe deklarata doganore. **Deklarata doganore është e paargumentuar, pasi këtë akses e kanë vetëm subjektet importues dhe bën që në procedurë të marrin pjesë një numër i kufizuar subjektesh.***

- *Është e paargumentuar pika e servisit. **Kriter i panevojshëm, pasi kemi të bëjmë me blerje mallrash dhe jo shërbime.***

- *Është e paargumentuar kriteri që shoqëria të paraqes fletë doganore për të gjithë mallrat (gomat), ndërkohë që mund të kërkohet fletë doganore për gomat por jo specifikime për markën që do ofrohet. (Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.3, faqet 50-88).*

1.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për eliminimin e praktikave të konstatuara në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për aplikimin e kriterëve të paargumentuara me procedurën e prokurimit dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike për vlerën **183,894 mijë lekë** pa TVSH.

Menjëherë

C/III. MASA PËR TË RRIUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, *u konstatua se:*

- APR-ja ka trashëguar nga ish- komunat, gjithsej **128** kontrata me objekt: “*Dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor*”, për një sipërfaqe totale prej 434.181 ha dhe vlerë kontrate të lidhur prej 28,354,583 lekë.

Pas njoftimit të bërë nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, me shkresën nr. 1826prot, datë 16.11.2018 “Për njoftimin e subjekteve debitorë”, për likuidimin e vlerës së kontratave të qirasë, konstatohet se nga **128** kontrata me vlerë 28,354,583 lekë është mundësuar arkëtimi i **18** kontratave me vlerë **8,235,079 lekë**, duke mbetur për arkëtim **110** kontrata me vlerë **20,119,504 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e APR-^{së}, veprime në kundërshtim me Urdhrin nr. 381, datë 12.10.2018 “Për vijimin e procesit të likuidimit të detyrimeve financiare që rrjedhin nga kontratat e qirave”, nenet 689 e vijues të ligjit nr. 7854, datë 27.07.1994 për “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.

- Konstatohet se, kontratat e marra në administrim nga ish-komunat, sipas Urdhrit nr. 2188/1 prot, datë 25.01.2017, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (*me procesverbalet*), rezultojnë se nuk kanë përmbushur qëllimi për të cilin janë lidhur, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” dhe ligjin nr. 7854 datë 27.07.1994 “Kodit Civil” të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, *pasi:*

a- Kanë një afat përdorimi mbi 10 vjet (*85 kontrata janë me afat 99 vite, 16 kontrata me afat 33 vite dhe 1 (një) kontratë me afat mbi 30 vite*), në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë

22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, lidhja nr. 2;

b-Tarifa vjetore të qirasë për ha/vit, janë llogaritur sipas Udhëzimit nr. 3, datë 16.05.2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe jo sipas VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”;

c- Nuk janë hartuar raporte tekniko-ekonomike të cilat duhet të ishin hartuar nga ish-DSHP Tiranë, ku të përcaktohej lloji i pyllit ose i bimësisë pyjore që shërben edhe si bazë për përlllogaritjen e çmimit të qirasë për ha/vit.

Gjithashtu, konstatohet se vlera e detyrimeve të paarkëtuara të 110 kontratave të qirave prej 20,119,504 lekë, nuk janë të regjistruara në kontabilitet në llog. 468 “*Debitorë*”, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; pika 1. Përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, standardet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4. (*Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.2.5, faqet 45-50*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave dhe Sektorin Juridik në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të paarkëtuara për **110** kontrata me vlerë **20,119,504 lekë**. (*Sipas pasqyrës përmbledhëse Aneks 3 bashkëlidhur Projekt Raportit dhe sipas tabelës së detajuar që disponon Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave*).

Të marrë masa për rishikimin e kontratave të lidhura nga ish- komunat në respektim të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 7854, datë 27.07.1994 “Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi kontratat e qirasë nuk kanë përmbushur qëllimin për të cilën janë lidhur.

Lidhja e kontratave të reja të bëhet sipas formës së kontratës TIP të miratuar nga Ministria e Mjedisit

1.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në APR, të marrë masa për kontabilizimin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore që rrjedhin nga kontratat e pyjeve dhe kullotave të trashëguara nga ish- komunat në shumën 20,119,504 lekë.

1.3.Rekomandim pas verifikimit: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave dhe Sektorin Juridik në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,472,553 lekë, pasi pas verifikimit të detyrave nga vlera e rekomanduar prej 20,119,504 lekë është arkëtuar vlera 17,646,951 lekë. Gjithashtu Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit të përshpejtoj procesin e rishikimit të kontratave të lidhura nga ish-komunat dhe rilidhjen e tyre sipas formës së kontratës TIP, të miratuar nga Ministria e Mjedisit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, gjatë ushtrimit të detyrave të ngarkuara nga VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit”, ka evidentuar sipërfaqe të cilat shfrytëzohen nga individ dhe subjekte, pa lidhur kontratë qiraje me APR, ku janë evidentuar gjithsej **188** ngastra me një sipërfaqe totale prej **692 ha**, në zonat kadastrale (ZK) që disponon Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave. Pavarësisht faktit se këto prona janë në administrim të APR, ato janë në përdorim nga persona të tretë për përfitime individuale, duke çuar në mungesë të të ardhurave për APR në vlerën prej **25,206,000 lekë**,

nga mos lidhja e kontratave dhe llogaritja e detyrimit për qiranë në zbatim të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

Konstatohet se, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave edhe pse ka evidentuar sipërfaqe të zaptuara nga të tretë dhe pa kontrata individuale, nuk janë kryer veprime të tjera ligjore për detyrimin e personave në lidhjen e kontratave të qirasë për sipërfaqet që ato kanë në përdorim, veprime në kundërshtim me shkronjën (b), pika 2, e nenit 17 dhe pika 1, të nenit 25 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”; Rregulloren e Brendshme nr. 1055/1, datë 28.06.2019 të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë; Ligjit nr. 48/2016, datë 05.05.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”; VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike”; Urdhrit nr. 2188/1 prot, datë 25.01.2017, i Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Gjithashtu, këto sipërfaqe janë të mbjella me kultura disa vjeçare dhe ndodhen në fazën e prodhimit, por për shkak të terrenit të vështirë nuk është bërë i mundur evidentimi në mënyrë të detajuar (*gjeneralitetet e poseduesit, sipërfaqe e zënë, lloji i kulturave të mbjella*), si dhe i sipërfaqeve pyjore të cilave ju është ndryshuar destinacionit. (*Më hollësisht trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit, pika III/2.2.5, faqet 45-50*).

2.1. Rekomandimi: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Tiranë, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialit të fushës së Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, ku të bëhet evidentimi në mënyrë të detajuar i sipërfaqeve të zaptuara nga të tretë dhe lloji i kulturave të mbjella me qëllim lidhjen e kontratave të qirasë për sipërfaqet që subjektet kanë në përdorim, për të shmangur mungesën e të ardhurave në vlerën **25,206,000 lekë**, nga mos llogaritja e detyrimit në zbatim të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

Për subjektet të cilat refuzojnë lidhjen e kontratës së qirasë, por që vazhdojnë të posedojnë pronën në kundërshtim me ligjin nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të merren masa konkrete duke i referuar në organet e prokurorisë për veprën penale “*Pushtimi i tokës*”, parashikuar nga neni 200 të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime

2.2.Rekomandim pas verifikimit:

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, të marrë masa për përshtetjen e procesit të evidentimit të sipërfaqeve pyjore të zaptuara dhe lidhjen e kontratave përkatëse të qirasë.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

D/I. Për Agjencinë e Prokurimit Publik

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet nr. 1, 12, 13, 14, 15, 16 datë 12.06.2020, nr. 19 dhe 20, datë 30.06.2020, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar trajtuar në Kap III/2.3, faqe 50-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenet 15 shkronja (c, ç) dhe neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo

rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **20 (njëzet) punonjës dhe ish- punonjës.**

Nga verifikimi rezultoi se Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar APP marrjen e masës administrative me gjobë për 20 persona. APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur marrjen e masës administrative me gjobë për 26 persona në vlerë totale 1.620.000 leke dhe masë disiplinore për 5 persona. Në zbatim të rekomandimeve ka dal urdhri nr. 09. date 12.01.2022, prot 45 date 12.01.2022 për “Marrjen e masave për zbatimin e vendimit të APP-së nr. 54, date 22.06.2021, nga ku rezulton se deri në momentin e verifikimit, ka filluar ndalesa për mbajtjen nga paga 9 punonjës në vlerën 540,000 lekë, ndodhet në proces gjyqësorë 11 persona në vlerën 680,000 lekë si dhe nuk është kryer asnjë procedurë për 6 persona në vlerën 400,000 lekë për të cilat KLSH rikërkon zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara. Në mënyrë të detajuar masat e rekomanduara nga KLSH paraqiten si vijon:

D/2 Masat e rekomanduara nga KLSH

1. z. B. H., me funksion ish- Zv/Drejtor i Përgjithshëm (periudha 10.12.2019 – 10.02.2020). Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur dënimin më gjobë në vlerën 60.000 lekë.

2. z. M. K., me funksion Përgjegjës i Sektori Ideim, Projektimi. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 80.000 lekë.

3. zj. R. Ç., me funksion specialist në Drejtorinë e Projektim dhe Zhvillimit. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 80.000 lekë.

4.zj.M. C., me funksion specialist në Drejtorinë Teknike dhe Operacional. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 80.000 lekë.

5. z.M. M., me funksion ish-Zv/Drejtor i Përgjithshëm, periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 60.000 lekë.

Ne Vendimin e APP-së nr. 57 datë 22.06.2021 janë shtuar dhe emrat si me poshtë:

6. z.B. S., me funksion ish-Zv/Drejtor i Përgjithshëm, periudha 23.01.2019 – 15.01.2020. Nga verifikimi rezultoi se APP me Vendimin nr. 57 datë 22.06.2021 ka vendosur te dënojë më gjobë në vlerën 40.000 lekë.

1.1. Rekomandim pas verifikimit të detyrave: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, bazuar në nenet 151, dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”, të marrin masa për arkëtimin vlerës 400,000 lekë ndaj 7 punonjësve dhe ish punonjësve ndaj të cilëve nuk është kryer asnjë procedurë sipas vendimit të APP si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore ndaj 19 punonjësve.

Menjëherë

III/2. BASHKIA KËLCYRË

-PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditim në Bashkinë Këlcyrë mbi: “Verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e evaduar në vitin 2021 për periudhën 01.01.2021 - 30.06.2021, paraqitur me shkresën nr. 612/10 datë 12.04.2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i evaduar në vitin 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si; vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore, vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, si IMTV, Komisioneve të Licencave, APP, e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Këlcyrë rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr.612/10 datë 12.04.2021, ndërsa nga Bashkia Këlcyrë për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje. Pra Bashkia Këlcyrë nuk ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor** nga momenti i dërgimit të shkresës për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, konstatohet se me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.612/10 datë 12.04.2021,dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 10.12.2021. Nga ana Bashkisë Këlcyrë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30-*Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.*

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 22 **masa organizative**, të cilat janë pranuar plotësisht sipas urdhrat të titullarit me nr. 440 prot datë 25.02.2022 dhe nuk janë zbatuar.

Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 6 masa me vlerë **16,342,059 lekë**, deri me datë 20.05.2022, nuk është arkëtuar asnjë **lekë**.

Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 3 masë në vlerën **55,970,640 lekë**, e pranuar dhe e pa zbatuar

Për masat administrative, i është rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me këto shkelje, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për 3 punonjës. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 82 datë 24.11.2021 ka vendosur masë Administrative për 4 persona në vlerën 320,000 lekë. Nga verifikimi rezulton se Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk ka ndërmarr asnjë veprim në zbatim të vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 2784 prot datë 26.11.2021.

Për masat disiplinore i është rekomanduar Bashkisë Këlcyrë të vlerësoj shkeljet e konstatuara nga KLSH si dhe të vendos masë disiplinore “Vërejtje” për 6 persona, masa të cila konsiderohen të realizuara.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve :

Niveli i realizimit të rekomandimeve është nën 20%, nga masat Bashkia Këlcyrë nuk ka mundur nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave si dhe nuk i ka shoqëruar të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

III. DREJTIMET E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Këlcyrë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.612/10, datë 12.04.2021 protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 819 datë 15.04.2021 ndërsa nga Bashkia Këlcyrë për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje KLSH bërë **brenda 20 ditësh**, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. **K. N.**

Pa zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Këlcyrë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.612/10, datë 12.04.2021,dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 12.10.2021.

Nga ana e Bashkisë Këlcyrë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH janë shkëlur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, *ku përcaktohet se*: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. **K. N.**

Pa zbatuar

3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021 **dhe nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr.

68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë. Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. **K. N.**

Pa zbatuar

IV. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar

C. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Këlcyrë 22 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht referuar urdhrin të titullarit me nr. 440 prot datë 25.02.2022. Sipas verifikimit rezultoi se nga ana e Bashkisë Këlcyrë nuk është ndërmarr asnjë procedurë ligjore për zbatimin e rekomandimeve të KLSH dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021. Në mënyrë të detajuar paraqitet si vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, si dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, nuk paraqesin drejtë gjendjen e tyre në fund të viteve ushtrimore 2018 dhe 2019.

Sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2018, ka rezultuar që llogaria 212 “Ndërtime dhe rikonstruksione” është rritur për shumën 6,675,337 lekë dhe llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është rritur për shumën 150,447,389 lekë, ndërsa sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2019, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është rritur për shumën 66,600,470 lekë.

Sipas dokumentacionit të verifikuar, këto vlera përfaqësojnë shpenzime kapitale, të papërfunduara, të pa kolauduara dhe të pa marra në dorëzim nga Bashkia Këlcyrë, ç’ ka do të thotë, se janë investime në proces dhe jo investime të kapitalizuara. Për rrjedhojë regjistrimi i tyre në kontabilitet, në debi të llogarive 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe jo në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.2. Rekomandimi: Nga ana e Përgjegjëses së Zyrës së Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë, të bëhen sistemimet kontabël si më poshtë:

- Sistemim në kontabilitet i llogarisë 212 “Ndërtime e Konstruksione” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” për shumën **6,675,377 lekë**, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit pasardhës, duke bërë veprimin kontabël në debi të llogarisë 231 dhe kredi të llogarisë 212;

-Sistemim në kontabilitet i llogarisë 213 Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” për shumën **150,477,389 lekë** në vitin 2018 dhe **66,600,470 lekë** për vitin 2019, në debi të llogarisë 231 dhe në kredi të llogarisë 213.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare

1.2.Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmarr asnjë procedurë.

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i analitikëve të llogarisë 202 “Studime e kërkime” konstatohet se, gjendja në fund të vitit 2018 dhe vitit 2019, për nëntë studime e projektme, të trashëguara nga Njësia Ballaban, paraqitet në vlerën zero lekë, (sipas Tabelave anekse nr. 3.2 dhe 3.3 “Studime dhe projektme të pa kontabilizuara”, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit). Kjo situatë ka sjellë që AAGJMM, të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (llogaria 230 “Studime dhe kërkime”) të mos paraqesin “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Këlcyre, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi. Duke qenë se këto aktive të trashëguara janë paraqitur me vlerë zero, nuk janë bërë hyrje në magazinë. Gjithashtu, është evidentuar se disa AAGJM, si “Ndërtesa e konstruksione”, (sipas Tabelave anekse nr. 3.4 dhe 3.5, trajtuar faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit) në fund të vitit 2019, janë paraqitur me vlera të ulëta (nën 100,000 lekë), vlera këto, jo reale në krahasim me vlerat e tregut për aktivet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2019, pika 105.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Këlcyre, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë, Nëpunësit Autorizues si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për vlerësimin e aktiveve jo materiale, bërjen hyrje në magazinë të tyre, si dhe rivlerësimin e aktiveve materiale, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi.

Gjashtë muaj

2.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyre me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmarr asnjë procedurë.

Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, për vitet 2018 dhe 2019, nuk janë përfshirë në inventarizim llogaritë: 210 “Toka, troje, terrene”; 211 “Pyje Plantacione”; 212 “Ndërtesa e Konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”; 215 “Mjete transporti” dhe aktivet afatshkurtra, si dhe për këto llogari, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, me të dhënat mbi, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e s’ kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Gjithashtu, është evidentuar se për vitin 2018, nuk është kryer inventarizimi i aktiveve, si dhe nuk disponohet asnjë dokumentacion, Urdhër i Kryetarit, për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2018.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Këlcyre, konkretisht:

- Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s’ kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

- Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”.

Menjëherë

3.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Këlcyrë, sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), më datë 02.11.2016 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime SHA, Këlcyrë, e cila është shoqëri aksionere me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij...”. Numri i aksioneve është 1,00 me vlerë nominale 21,259,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 21,259,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Këlcyrë, në Ujësjiellës Kanalizime SHA, Këlcyrë, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Pasqyrës së Pozicionit Financiar të viteve 2018 dhe 2019, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 64, datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. Mos pasqyrimi i vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 21,259,000 lekë, në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, përbën deformim të informacionit financiar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të Ujësjiellës Kanalizime SHA, Këlcyrë, me vlerë kontabël **21,259,000 lekë**, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare

4.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në fund të viteve ushtrimore 2018 dhe 2019, gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” është në vlerën 6,078,720 lekë, e cila analitikisht përfaqëson debitorë për penalitete dhe kamatëvonesa, vlerë e cila nuk është e saktë. Në asnjë rast, nuk janë evidentuar në llogaritë analitike si për vitin 2018 dhe 2019, debitorët për taksat dhe tarifavat vendore. Sipas rakordimit me zyrën e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Këlcyrë, detyrimet e evidentuara për vitet 2018 dhe 2019, janë dërguar me shkresat përcjellëse me nr. 259, datë 01.02.2019 për vitin 2018 dhe nr. 331, datë 14.02.2020, për vitin 2019, Zyrës së Financës dhe sipas tyre, detyrimi paraqitet në vlerën 53,051,426 lekë në vitin 2018 dhe 60,386,981 lekë për vitin 2019. Për rrjedhojë nuk është pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe në kundër partinë llogaritë e klasës 7,

vlera prej 53,051,426 lekë për vitin 2018, dhe vlera prej 60,386,981 lekë për vitin 2019, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke e debituar për vlerën 53,051,426 lekë për vitin 2018 dhe 60,386,981 lekë për vitin 2019. Gjithashtu, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit” të vitit në vazhdim.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare

5.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” paraqitet në shumën 6,714,053 lekë për vitin 2018 dhe 7,622,212 lekë për vitin 2019. Në mënyrë analitike kjo llogari ka përfshirë në debi, gjendjet e llogarive kreditore të detyrimeve 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” dhe 435 “Sigurime Shoqërore” për secilin vit përkatës. Nga ana tjetër janë analizuar dhe kontratat e investimeve si dhe financimi i këtyre angazhimeve sipas PBA-së 2017-2018-2019, trajtuar në Tabelën anekse nr. 3.6 “Mbi financimin e pritshëm nga buxheti”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për sa i përket të drejtave që i lindin subjektit Bashkia Këlcyrë, për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit, në lidhje me këto angazhime të ndërmarra, gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019, konstatohet se bazuar në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 32 e tij, ky kontabilizim nuk është bërë, gjë që ka sjellë mos pasqyrimin e detyrimeve të buxhetit kundrejt Bashkisë Këlcyrë, për shumën 69,955,690 lekë në vitin 2018 dhe për shumën 237,523,073 lekë në vitin 2019, në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për shumën 69,955,690 lekë për vitin 2018 dhe për shumën 237,523,073 lekë për vitin 2019. Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2020.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare

6.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, pas analizimit të të gjitha kontratave të lidhura për investime kapitale, sipas Tabelës anekse nr. 3.7 “Detyrimet e prapambetura” faqe nr. 58 e Raportit Përfundimtar të Auditimit, paraqitja e detyrimeve të prapambetura në kontabilitet, nuk është vlerën e saktë.

Në Bilancin Kontabël për vitin 2018 dhe 2019 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe kundër partia 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vitin 2018 në vlerën 386,712 dhe për vitin 2019 në vlerën 630,628 lekë, ç’ ka do të thotë se, detyrimi i prapambetur lindur nga shpenzimet kapitale në vitet 2018 dhe 2019, nuk është pasqyruar. Kjo ka sjellë, mos pasqyrimin e saktë të gjendjes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën 6,052,070 lekë, për vitin financiar të mbyllur 2018 dhe 4,335,775 lekë, për vitin financiar të mbyllur 2019.

Këto llogari, gjithashtu nuk paraqesin drejtë gjendjen e tyre për vitin 2019, për shkak edhe të mos njohjes së detyrimit që ka lindur në vitin 2019 (referuar datës së faturës), por që janë likuiduar (lëvizja cash) në vitin 2020, për vlerën 20,109,193 lekë.

Në rastet e mësipërme, është shkelur një nga parimet kryesore të kontabilitetit “të drejtat dhe detyrimet e konstatuara”, pra evidentimi i shpenzimeve në kontabilitet në momentin kur ndodh ngjarja.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi:

- Nga Bashkia Këlcyre, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën **6,052,070 lekë**, diferencë e vitit financiar të mbyllur 2018 dhe **4,335,775 lekë** diferencë e vitit financiar të mbyllur 2019, si dhe të sistemohet në kontabilitet vlera prej **20,109,193 lekë** e faturave të cilat janë likuiduar në vitin 2020, por që detyrimi ka lindur në vitin 2019, në llogaritë përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

- Nga ana e Bashkisë Këlcyre, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare

7.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyre me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e kryerjes së shpenzimeve, me objekt investimet kapitale të vitit 2018 dhe 2019 rezultoi se, në përgjithësi faturat tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimeve, kanë datë lëshimi të mëvonshme nga data e situacionit përkatës. Paraqitja e faturave tatimore, në data të mëvonshme nga datat e situacioneve të punimeve, është në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, gjë për të cilën parashikohet penalitet për investitorët, për mospagim në afat të TVSH-së, i cili arrin vlerën e 455,084 lekë, sipas Tabelës anekse nr. 3.1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Kjo shumë konsiderohet një e ardhur (jo tatimore) e munguar në buxhetin e shtetit.

Nga auditimi i transaksioneve lidhur me shpenzimet e investimeve, për periudhën objekt auditimi, janë evidentuar raste, ku dokumentacioni i paraqitur për justifikimin e shpenzimeve, ka rezultuar i paplotë, konkretisht janë paraqitur nga investitorët situacione pa data. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7, 12, dhe 18 si dhe UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Gjithashtu, pranimi i dokumentacionit vërtetues të parregullt dhe të pa plotë, është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4, pika 26, me neni 6 të UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 35 dhe 36, është përgjegjësi e nëpunësit zbatues.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues i Bashkisë Këlcyrë, të merren masa që likuidimi i shpenzimeve të kryhet bazuar në dokumentacion të plotë, autorizues dhe vërtetues të shpenzimit kapital. Nga Nëpunësi Autorizues të dërgohet shkresë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, ku të vihet në dijeni për gjendjen e debitore të subjekteve “R.” SHPK me NIUS J.....E dhe “B.” SHPK, me NIUS K.....A, shkaktuar si rezultat i mospagimit në afat të TVSH-së, në vlerën **455,084 lekë**.

Menjëherë dhe vijimësi

8.2.Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hartimin e Programeve Buxhetore Afatmesme (PBA) ka rezultuar se Bashkia Këlcyrë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36 dhe 37; UMF nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, shtojca 5; UMF nr. 22, datë 30.07.2017 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”, shtojca 1; UMF nr. 6/3, datë 10.07.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor” dhe UMF nr. 7, datë 27.02.2019 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022”, kapitulli 1.

Mbi programimin e PBA-së 2018-2020; 2019-2021 dhe 2020-2022 është konstatuar se:

- Nga ana e Titullarit të Institucionit, nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS);
- Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor brenda muajit dhjetor të viteve paraardhëse;
- Nga Kryetari i Bashkisë nuk është paraqitur për shqyrtim dhe miratim raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve brenda datës 15 Mars (të vitit paraardhës);
- Nuk janë miratuar nga Këshilli Bashkiak, vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Nuk janë organizuar seanca dëgjimore me qytetarët si dhe nuk është prezantuar dokumenti i PBA me shoqërinë civile;
- Nuk është dërguar brenda datës 1 Qershor 2017 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dokumenti i programit buxhetor afatmesëm (PBA 2018-2020);
- Nuk janë miratuar në Këshillin Bashkiak, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (të vitit paraardhës);
- Nga Njësitë shpenzuese të Bashkisë, nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore të rishikuara, si dhe nga Njësia Përgjegjëse për buxhetin në Bashkinë Këlcyrë, nuk janë kryer analizat e kërkesave buxhetore;
- Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak programi buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxhetin vjetor brenda datës 25 dhjetor (të vitit paraardhës).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Projekt Raportit të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Këlcyre, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues dhe Kryetarit të GMS-së, si dhe Nëpunësi Zbatues, për zbatimin e të gjitha procedurave ligjore, për programimin e buxheteve vjetore dhe afatmesme, duke krijuar

grupet e punës sipas projekteve të financimit, duke ndjekur dhe zbatuar kalendarin e programimit të buxhetit, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë dhe vijimësi

9.2.Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se treguesit buxhetor të planifikuar dhe miratuar për periudhën objekt auditimi, paraqiten në nivele të ulëta realizimi. Kështu, është evidentuar nivel i ulët i realizimit të planit të të ardhurave, ku për vitin 2018, paraqiten me realizim në masën 67 % kundrejt planit dhe për vitin 2019, paraqiten me realizim në masën 51 % kundrejt planit.

Viti	Të ardhura të veta-000/lekë				Shpenzimet buxhetore-000/lekë			
	Plan	Fakt	Diferenca	%	Plan	Fakt	Diferenca	%
2018	19,386	13,115	-6,271	67	394,861	363,438	-31,423	92
2019	20,047	10,290	-9,757	51	378,868	356,362	-22,506	94

Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta, gjë e cila ka ndikuar në mosrealizim të shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë, duke shtuar riskun për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e Titullarit dhe të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, duhet të marrin masa, që gjatë procesit të planifikimit të PBA-ve dhe buxheteve vjetore, të mbështeten në analiza të hollësishe mbi kapacitetet ekonomike, financiare dhe resurset e territorit nën administrim, për një planifikim sa më objektiv dhe real të të ardhurave, me qëllim mos krijimin e diferencave të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të buxhetit, gjë e cila shoqërohet me marrje angazhimesh për kryerje shpenzimesh, si dhe mos likuidim të tyre për shkak të mungesës së likuiditetit.

Në vijimësi

10.2.Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Këlcyrë ka trashëguar dhe ka krijuar detyrime të prapambetura për periudhën objekt auditimi, të cilat nuk kanë gjetur pasqyrim real në planifikimin e buxheteve vjetore, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe udhëzimet standarde për zbatimin e buxheteve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, konkretisht:

- Në vitin 2017, është prokuruar objekti: “Rijetëzim i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin qendër” me vlerë 148,783,112 lekë me TVSH, me burim financimi nga FZHR, ku likuidimi i këtij investimi në 31.12.2017 paraqitet në vlerën 37,227,210 lekë dhe likuidimi në 31.12.2018 paraqitet në vlerën prej 107,222,064 lekë. Detyrimi i mbetur për vitin 2018 dhe 2019 është në vlerën prej 4,333,838 lekë, detyrim i cili nuk është planifikuar në PBA 2018-2020 si dhe në Planin e buxhetit të vitit 2019.
- Në vitin 2018, është prokuruar objekti: “Rikonstruksion i urës në qendër të qytetit Këlcyrë” me vlerën 4,943,420 lekë me TVSH, me burim financimi nga të ardhurat e veta, ku likuidimi

i këtij investimi në 31.12.2018 paraqitet në vlerën 3,240,550 lekë. Detyrimi i mbetur për vitin ushtrimor 2018 është në vlerën prej 1,702,870 lekë, detyrim i cili nuk është planifikuar në PBA 2018-2020 si dhe në Planin e buxhetit të vitit 2019.

- Në vitin 2018 rezulton se, vendimi gjyqësor i lindur si detyrim në Bashkinë Këlcyrë, me nr. ekzekutimi 64 datë 14.11.2018, me vlerë 150,000 lekë, nuk është njohur si detyrim në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018, si dhe nuk paraqitet si detyrim në Planin e Buxhetit të vitit 2019 dhe PBA 2019-2021.

- Në vitin 2019 rezulton se, vendimi gjyqësor i lindur si detyrim në Bashkinë Këlcyrë me nr. ekzekutimi 1249 datë 28.10.2019, me vlerë 429,000 lekë, nuk është njohur si detyrim në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2019, si dhe nuk paraqitet si detyrim në Planin e Buxhetit të vitit 2020 dhe PBA 2020-2022.

- Gjithashtu, është konstatuar se në vitin 2019, është prokuruar objekti “Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit” me vlerë 34,858,247 lekë me TVSH dhe objekti “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran” me vlerë 36,353,317 lekë me TVSH, me burim financimi nga të ardhurat e Bashkisë, pa miratuar si objekt në Këshillin e Bashkisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandimi:

- Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit dhe Nëpunësit Autorizues, si dhe Nëpunësi Zbatues, duhet të marrin masa që gjatë procesit të planifikimit të buxheteve vjetore, të planifikojë mbulimin me buxhet, së pari për detyrimet e papaguara dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.

- Gjatë zbatimit të buxheteve vjetore, për investimet që financohen nga të ardhurat e veta të merret paraprakisht miratimi në Këshillin Bashkiak, të zbatohen të gjitha procedurat ligjore bazuar në udhëzimet vjetore dhe standarde të planifikimit dhe zbatimit të buxheteve vjetore.

Në vijimësi

11.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr.612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi subjektet, që ushtrojnë aktivitet në shtrirjen territoriale administrative të Bashkisë Këlcyrë të regjistruara në QKB (referuar të dhënave të Tabelës nr. 2.3.2 “Gjendja e subjekteve të regjistruara”, faqe 30 e RPA), konstatohen se për vitet objekt auditimi, ka 5 regjistrime të reja dhe 45 subjekte mbyllje aktiviteti, nga të cilat: Për vitin 2018, kanë ushtruar aktivitet 201 subjekte (184 subjekte të biznesit të vogël, 17 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera e institucione), për vitin 2019, kanë ushtruar aktivitet 163 subjekte (142 subjekte të biznesit të vogël, 21 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera e institucione).

Kjo situatë faktorizohet jo vetëm nga niveli i ulët ekonomik i Bashkisë Këlcyrë, por dhe nga puna e pa mjaftueshme e strukturave të Sektorit të Tatim Taksave, pasi:

- Nuk janë mbajtur regjistra manual për bizneset që ushtrojnë aktivitet tregtar etj, për të rritur sigurinë e informacionit që disponojnë, nisur nga fakti se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon program kompjuterik të licencuar dhe të mbrojtur.

- Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe kontrollit fizik të dokumentacionit rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, nuk është administruar në dosjet e bizneseve që janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, deklarata tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore.

- Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe auditimi fizik i dokumentacionit, rezulton se nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk është marrë informacion nga

Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, mbi xhiron e subjekteve, ku mbi bazën e këtyre të dhënave aplikohen dhe taksat vendore sipas llojeve të biznesit (fizik/juridik).

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se, 36 subjekte të biznesit të vogël, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në Bashkinë Këlcyrë dhe Njësitë Administrative, Sukë, Ballaban, Dishnice, nuk janë regjistruar në QKB, kjo ngarkon me përgjegjësi Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, i cili nuk ka ndërmarrë veprimet ligjore për detyrimin e këtyre subjekteve që të regjistrohen në QKB, por është mjaftuar vetëm me evidentimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 41 dhe nenin 121, pika 1 germa b. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi:

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që deklarojnë mbyllje aktivitet, nëse deklarimi është i saktë si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të peregjistruar në QKB.

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, duhet të marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar numrin e subjekteve fizik/juridik si dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara të bëhet aplikimi i taksave dhe tarifave vendore.

Menjëherë

12.2.Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi aktivitetin e agjentëve tatimorë për të ardhurat që arkëtohen dhe kalojnë në Bashkinë Këlcyrë, u konstatua se nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore, midis Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë dhe Agjentëve Tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja Dega Gjirokastrë, nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji (brenda datës 5 të çdo muaji), për llogari të Bashkisë Këlcyrë nisur nga fakti se, në vitet 2018 dhe 2019 nuk ka asnjë arkëtim. Rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, në lidhje me Tatim Fitimin e Thjeshtuar, nuk janë mbajtur rregullisht në fund të çdo muaji dhe nuk ka informacion sa subjekte duhet të paguajnë dhe sa jo, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 70 pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi:

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimorë, sipas llojit të taksës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë, si dhe të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë.

- Të krijohet baza e të dhënave për subjektet, tarifatat dhe taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera dhe të kryejë rakordimet në fund të çdo muaji, sipas formularit përkatës, të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë

13.2.Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është evidentuar realizim i ulët i të ardhurave dhe shpenzimeve nga ana e Bashkisë Këlcyrë, gjë e cila flet për punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre, ku si rezultat i mos arkëtimeve, sjell si pasojë që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2018 dhe në buxhetin e vitit 2019, të mbeten pa burim financimi, duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe borxhin. Konkretisht:

- Për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 19,386,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 13,115,000 lekë, **ose 68 % me një diferencë në vlerën 6,271,000 lekë.**

- Për vitin 2019, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 20,047,000 lekë të parashikuara, janë realizuar, në vlerën 10,290,000 lekë, **ose 51%, me një diferencë në vlerën 9,757,000 lekë.**

- Niveli i arkëtimeve për taksat vendore nga njëra periudhë në tjetër vjen në ulje, ku për vitin 2018, paraqitet në shumën 13,115,000 lekë, ndërsa në vitin 2019 paraqitet në shumën prej 10,290,000 lekë **ose më pak në shumën prej 2,825,000 lekë ose 12% më pak.** Kjo tregon punë pamjaftueshme të administratës së tatim taksave të Bashkisë Këlcyrë në menaxhimin e të ardhurave si në fazën e planifikimit po ashtu dhe të realizimit të tyre.

- Mos evidentimi dhe regjistrimi i debitorëve realë, nga Zyra e Financës, mos arkëtimi i detyrimeve debitorë, gjithashtu ka sjellë mungesë të ardhurash për Bashkinë Këlcyrë.

- Përsa më sipër, faktorët që kanë ndikuar në realizimin e të ardhurave janë:

- Nga të dhënat ka rezultuar se, nuk është mbajtur akt-rakordim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimor.

- Gjithashtu dhe në fazën e planifikimit nuk është marrë në konsideratë numri i subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën e të dhënave për subjektet të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore, do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

- Nga verifikimi rezulton se, nuk është rakorduar (çdo 6-muaj) me Drejtorinë e Tatimeve të Qarkut Gjirokastër, për realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, në cilësinë e agjentit tatimor.

- Të ardhurat nga taksat kombëtare, për vitin 2018, nuk janë planifikuar, kjo tregon për mos njohje të burimeve dhe resurseve që ka Bashkia Këlcyrë, si dhe mos njohja e kuadrit ligjor që rregullon përfitimin e njërive vendore nga këto taksa.

- Taksa e mjeteve të përdorura, është planifikuar sipas të dhënave historike, pra nuk ka një data bazë të saktë, për numrin e mjeteve në përdorim që gjenden në territorin e Bashkisë Këlcyrë.

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e taksave të popullatës është mjaftuar vetëm duke detyruar familjet që marrin shërbim (vërtetime etj.) në Bashkinë Këlcyrë, të paguajnë tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

- Nga auditimi rezulton se nuk është kryer rakordim me zyrat e gjendjes civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Këlcyrë.

- Realizimi i të ardhurave nga arkëtimi i detyrimeve të debitorëve të ndryshëm është në shumën 0 lekë, për të dy vitet objekt auditimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis sektorëve dhe bashkëpunimin me struktura të tjera si: Qendrën

Kombëtare të Biznesit, Drejtorinë e Tatimeve Gjirokastër, Zyrën e Gjendjes Civile, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, etj me qëllim:

- Kryerjen e rakordimeve me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, (në cilësinë e agjentit tatimor) për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë, si dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimor, si dhe kryerjen e rakordimeve 6-mujore mbi realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;
- Marrjen e të dhënave mbi bizneset në QKB, që në fazën e planifikimit, mbi numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllën ose regjistrohen, dhe bazën e të dhënave për subjektet, të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore, do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;
- Marrjen e masave për evidentimin e resurseve, analizimin dhe planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare;
- Marrjen e masave për kryerjen e rakordimeve me Zyrën e Gjendjes Civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Këlcyrë, si dhe marrjen e masave për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Menjëherë

14.2.Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 1304, datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim Rruga “Sukë Podgoran Fushë”, Rruga “Goricë”, Rruga “Komarak e Vinokash”, Rruga “Gur Fshat Këlcyrë” dhe Rruga “Riban””, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1046, datë 07.05.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor është miratuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve 1.7-2.5 herë më shumë, se afati fillestar i përfundimit të punimeve, pa patur asnjë argument teknik të besueshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa, për nxjerrjen e përgjegjësive në rastet e shtyrjes së afatit të zbatimit të kontratave në mënyrë të pa argumentuar teknikisht, si dhe për ndjekjen në kohë të zbatimit të kontratave, në mënyrë që të respektohet afati i përfundimit të punimeve, duke aplikuar penalitete për kontraktorin në rast të shkeljes së afatit, si dhe për vënien e objekteve në kohë në efikasitet të plotë, për arritjen me sukses të impaktit tek qytetarët.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.2.Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 1304, datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim Rruga “Sukë Podgoran Fushë”, Rruga “Goricë”, Rruga “Komarak e Vinokash”, Rruga “Gur Fshat Këlcyrë” dhe Rruga “Riban””, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1447, datë 01.07.2019, me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi”, Bashkia Këlcyrë, nuk

administrohej leja e ndërtimit, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 39, “Leja e ndërtimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa që para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 1304, datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim Rruga “Sukë Podgoran Fushë”, Rruga “Goricë”, Rruga “Komarak e Vinokash”, Rruga “Gur Fshat Këlcyrë” dhe Rruga “Riban””, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1447, datë 01.07.2019, me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi”, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1046, datë 07.05.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë, rezultuan diferenca në volume dhe për pasojë dëm ekonomik, ndërkohë që vlera e kontratave të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve ishin të gjitha 0 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të analizohen shkaqet që kanë shkaktuar diferenca në volume gjatë zbatimit të punimeve në këto objekte dhe në rast të neglizhencës së mbikëqyrësve dhe kolaudatorëve, për shkak të dhënies së shërbimit pa kosto, të merren masa që të vlerësohet kostoja e këtyre shërbimeve, sipas legjislacionit në fuqi dhe të bëhet prokurimi i këtyre fondeve, me qëllim kryerjen e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve me përgjegjësi të lartë profesionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe miratimin e DT, u evidentuan mangësitë e mëposhtme:

-Në "Kriteret e veçanta për kualifikim", përsa i përket numrit të punonjësve dhe stafit teknik, që duhet të disponojë operatorët ekonomikë për realizimin e kontratës, nga ana e NJP në asnjë prej procedurave, nuk është dhënë asnjë argument, mbi përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve dhe të stafit teknik, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2;

- Përsa i përket përmbushjes së kriterit mbi punët e të njëjtës natyrë apo ngjashme të realizuar në sektorin privat, në të gjitha procedurat, është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin Lejen e ndërtimit për objektin e realizuar. Kjo kërkesë, nuk ka të bëjë me qëllimin e përmbushjes së këtij kriteri, nga OE në garë, si dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, nenin 26 pika 6 germa b;

- Në procedurat e prokurimit, përsa i përket dokumentimit që duhet të paraqitet nga operatorët ekonomikë, për mjetet e transportit dhe lejet që duhet të disponojnë, nga NJP nuk

është përcaktuar qartë dokumentacioni i kërkuar, për përmbushjen e këtij kriteri. Në DT, është kërkuar që të paraqitet "Leje transporti që lëshohet nga njësia vendore", ndërkohë që duhet të cilësonin saktë këtë kërkesë duke kërkuar "Leje transporti për përdorim për të tretë", veprim në kundërshtim me VKM, neni 26 "Kontrata për punë publike" pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (AK), konkretisht Njësia e Prokurimit (NJP) në përcaktimin e kriterëve kualifikuese, duhet të:

- analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kriterë të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, të qarta dhe të kuptueshme për operatorët ekonomikë, si dhe për çdo rast, duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës, që mbahet për këtë qëllim;
- shmangin vendosjen e kërkesave, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Në vijimësi

18.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Këlcyrë, nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", konkretisht:

- Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, gjë e cila është reflektuar në mangësinë e plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.
- Nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitet 2018, 2019 dhe 2020 edhe pse në Ministrinë e Financave në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, është raportuar nëpërmjet pyetësorit të plotësuar, ekzistenca e një GMS të ngritur me urdhër nga titullari.
- Në strukturën organizative për vitet objekt auditimi pavarësisht se është përcaktuar pozicioni i punës së Përgjegjës të zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juristit, ky pozicion rezulton të jetë vakant për gjithë periudhën e audituar, ndërkohë që nuk ka asnjë shpallje për vend të lirë pune.
- Bashkia Këlcyrë, nuk ka miratuar në strukturë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, strukturë kjo e rëndësishme për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve, por edhe për mbrojtjen e territorit.
- Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2018, 2019 dhe 2020, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njesisë.
- Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, si dhe nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.
- Nga auditimi i dosjeve të punonjësve u konstatua se përgjithësisht, nuk ishte nënshkruar kontrata e punës, siç përcaktohet nga Kodi i Punës, por ishte mjaftuar vetëm me Urdhrin e emërimit të nxjerrë nga Titullari.
- Gjithashtu, u konstatua se një numër i konsiderueshëm punonjësish, kanë rregulluar marrëdhënien e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që pozicionet e tyre të punës, evidentohen si pozicione me status "Nëpunës Civil" dhe për rrjedhojë rekrutimi i tyre është bërë në kundërshtim me ligjin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Këlcyre, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshtatjet të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësisë dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.
- Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të hartohet strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.
- Plotësimin e pozicioneve vakante si: Përgjegjës i zyrës së Burimeve Njerëzore dhe pozicionin e Juristit të njësisë, Auditues të brendshëm, Inspektorë të kontrollit të territorit, si pozicione të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit në mënyrë ligjore.
- Ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim mbrojtjen e territorit nga ndërtime të paligjshme.
- Hartimin dhe plotësimin e gjitha dosjeve të punonjësve me kontratën individuale të punës, konform përcaktimeve të “Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë”.
- Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civilë”, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si punonjës bazuar në “Kodin e Punës”, si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.

Brenda 3 (tre) muajve.

19.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

20. Gjetje nga auditimi: Bashkia Këlcyrë, nuk ka një strukturë funksionale të auditit të brendshëm, pavarësisht caktimit në organikë të një pozicioni për auditues. Ky pozicion rezulton vakant për gjithë periudhën e auditimit. Titullari i institucionit, në mungesë të Njësisë së Auditit të Brendshëm, nuk ka lidhur marrëveshje me njësi tjera publike të cilat kanë njësi auditit të brendshëm, si dhe kapacitete të nevojshme për kryerjen e auditit të brendshëm në sektorin publik, veprime në kundërshtim me ligji nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10 germa (a) dhe (c) dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, neni 6 germa (a).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në një nga format e përshtatshme që përcakton kuadri ligjor.

Menjëherë

20.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se:

- Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, ka nxjerrë Urdhrin nr. 75, datë 31.08.2018 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e programit të punës dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së” në tejkallim të afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e

Kontrollit të Lartë të Shtetit". Shkresa përcjellëse e KLSH për dërgim Raporti Përfundimtar Auditimi dhe Rekomandime me nr. 248/10, datë 29.06.2018, është protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me nr. 1364, datë 04.07.2018, ç' ka do të thotë se afati i fundit për dërgimin e përgjigjes mbi programin/planin e masave për zbatimin e rekomandimeve është 25.07.2018. Ky urdhër ka dalë 36 ditë më vonë. Gjithashtu, Grupi i punës, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për hartimin e programit për masat që duhet të merren për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë edhe pse me vonesë. Nga Bashkia Këlcyrë, nuk është dërguar në KLSH, programi (plan veprimi) mbi masat që duhet të ndërmerren nga subjekti, mbi zbatimin e rekomandimeve, brenda afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", germa (j);

- Mbi zbatimin e plan-veprimit dhe raportimin në KLSH, nga auditimi rezultoi se, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 248/10, datë 29.06.2018, i ka dërguar Bashkisë Këlcyrë, Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Shkresën përcjellëse me rekomandimet e lëna. Bashkia Këlcyrë, duhet të raportojë me shkrim mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve brenda 6-muajsh, nga marrja e Raportit të Auditimit dhe Shkresës përcjellëse mbi rekomandimet e lëna. Bashkia Këlcyrë nuk e ka zbatuar këtë detyrim ligjor, pasi nuk ka raportuar me shkrim në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30 "Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit";

- Nga auditimi rezultoi se Bashkia Këlcyrë, nuk ka bërë raportime në Këshillin Bashkiak, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i jashtëm (KLSH), referuar kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 113-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1. Rekomandim: Nga ana e Këshillit Bashkiak të analizohet gjendja e konstatuar në këtë auditim, të nxirren përgjegjësitë si dhe t'i kërkohej Kryetarit të Bashkisë, që të raportojë rregullisht, mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Menjëherë e vijimësi

21.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmarr asnjë procedurë.

Pa zbatuar

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, ka rezultuar se:

- Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 14 "Masa organizative", nga të cilat janë zbatuar plotësisht 4 masa; janë zbatuar pjesërisht 4 masa; është në proces zbatimi 1 masë dhe **nuk janë zbatuar 5 masa.**

- Në auditimin e mëparshëm, janë rekomanduar 11 masa shpërblim dëmi, në vlerën 38,657,994 lekë, të pranuar dhe për të cilat kanë dalë njoftimet nga Titullari. Nga auditimi rezultoi se, **nuk janë kontabilizuar dhe nuk është arkëtuar asnjë vlerë.** Nga Bashkia Këlcyrë, nuk është paraqitur asnjë argumentim ligjor, për mos arkëtimin e dëmit, si dhe nga subjektet dhe punonjësit e atakuar, nuk është kryer ankimim në Gjykatën Administrative, për kundërshtim të shpërblimit prej tyre, të dëmit ekonomik të ngarkuar.

- Për shkeljet e konstatuara në auditimin e mëparshëm, janë dhënë masa disiplinore dhe administrative për t'u zbatuar nga strukturat përkatëse të ngarkuara me ligj. Nga auditimi ka rezultuar se nga 6 masa disiplinore, të rekomanduara nga KLSH dhe 2 masa disiplinore, të

dhëna nga APP deri më 30.06.2020, janë zbatuar plotësisht 5 masa dhe janë zbatuar pjesërisht 3 masa disiplinore.

- Në auditimin e mëparshëm, KLSH i është drejtuar APP-së, për dhënien e masave administrative për 7 punonjës. Nga APP, ka dalë vendimi nr. 109, datë 16.11.2018, protokolluar në Bashkinë Këlcyre me nr. 2264, datë 20.11.2018, për vendosjen e gjobave për 9 punonjës dhe masa disiplinore për dy punonjës. Nga auditimi ka rezultuar se janë zbatuar masat disiplinore të dhëna nga APP për dy punonjës, por nuk është zbatuar asnjë prej 9 masave administrative “gjobë” për 9 punonjës. Nga ana e subjektit janë pranuar gjobat e vendosura nga APP, pasi kanë dalë Njoftimet e titullarit për personat përkatës, si dhe nga ana e personave të atakuar, përsa i përket gjobave të vendosura nga APP, nuk ka ankime në Gjykatën Administrative, për rrjedhojë nuk ka asnjë argument ligjor për mos kontabilizim dhe mos arkëtim të tyre në vlerën totale 1,400,000 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 113-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1. Rekomandim: Këshilli Bashkiak, të marrë në analizë rezultatet e auditimit mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë, pasi për shkak të moszbatimit të tyre, **edhe në auditimin e radhës janë evidentuar shkelje, mangësi, si dhe veprime, në kundërshtim me kriteret e vlerësimit, të cilat janë të përsëritura.** Nga ana e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Këlcyre, t’i kërkohet Kryetarit të Bashkisë, marrja e masave për shqyrtimin, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e mëparshëm, të cilat rezultojnë të pa zbatuara apo të zbatuara pjesërisht, të trajtuara rast pas rasti, në mënyrë të hollësishme në Aneksin nr. 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

22.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyre me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmarr asnjë procedurë.

Pa zbatuar

D.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102; Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 93, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Këlcyre), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi zbatues të ndiqet procesi me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 16,342,059 lekë** si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi se vlera **16,342,059 lekë** nuk është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 –debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2021 (bilanci vjetor 2021) vlera prej **16,342,059 lekë**. Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej **16,342,059 lekë**, deri më datën 20.05.2022 nuk është arkëtuar asnjë lekë.

Nga ana e Bashkisë Këlcyre më datë 17.05.2022 mbas programit të auditimit të zbatimit të rekomandimeve nr. 445 prot., datë ka nxjerr njoftimet për subjektet debitorë në lidhje me detyrimet e konstatuara nga KLSH dhe deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmarr asnjë procedurë tjetër për sa më sipër rekomandimet për masa shpërblim dëmi do të konsiderohen të pa realizuar. Bazuar në nenin 15 germa (c) dhe (ç), si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” ngarkohet me përgjegjësi **z. K. N.**, në cilësinë e Titullarit të Njësisë Publike, Bashkia Këlcyre, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin

financiar dhe kontrollin” me ndryshime, Kreu II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1. Në menyrë të detajuar rekomandimet paraqiten si vijon:

Rekomandimet, arkëtimet dhe natyra e rasteve të mos realizimit mëposhtmet tyre:

Nr	Emër Mbiemër/Subjekti	Numri rekomandimit sipas shkresës (Vendimit)	Natyra e Shkeljes	Rekomanduar Gjithsej në Lekë	Nuk Pranohen nga Subjekti	Janë pranuar Në lekë	Nga të pranuarat:			
							Arkëtuar Deri 15.05.21	Në Proces Arkëtim	Në Proces Gjyqësor	Nisur Njoftime e s'kanë Paguar
a	b	c	d	1	2	3 (2-1)	4	5	6	7
1	D.- Shpk E. Shpk D. Shpk A. Shpk	1.1	Autorizim Karburantet	11,000,000						Po
2	J. SHPK	2.1	Punimeve të pakryera	1,951,600						Po
3	H. SHPK	3.1	Punimeve të pakryera	1,280,596						Po
4	(sipas Tabelës nr.2.3.10 “Tarifat për subjektet me investime mbi 5 milionë lekë”	4.1	Nipt sekondar	1,165,000						
5	H. SHPK	5.1	Punimeve të pakryera.	591,263						Po
6	z. S. V. dhe z. B. I.	6.1	Përllogaritje e gabuar e fondit limit	353,600						Po

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nga Bashkia Këlcyre dhe Njësitë Administrative, për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, nuk është vepruar në përputhje me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35, VKM nr.170, datë 25.04.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar kapitulli II, kapitullit III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II pika 1, germa b dhe VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa shtresa dhe ndryshime në VKM nr. 970, datë 02.12.2015”, pasi ka mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektsh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative (Dishnice, Sukë dhe Ballaban), **nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet në shumën prej 11,000,000 lekë.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa **për arkëtimin e detyrimit prej 11,000,000 lekë**, për 4 subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pa pajisur me autorizim/licencë për tregtimin e karburanteve, kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM nr.344 datë 19.04.2017, respektivisht për subjektet si më poshtë:

- Subjekti D.-OIL, për vlerën prej 2,200,000 lekë.
- Subjekti E.SHPK, për vlerën prej 4,400,000 lekë.
- Subjekti D. , për vlerën prej 3,300,000 lekë.

-Subjekti A.SHPK, për vlerën prej 1,100,000 lekë.

Menjëherë

1.2.Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, me vlerë të kontratës (me TVSH) 34,858,247 lekë dhe kontraktor subjektin “**J.**” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,951,600 lekë pa TVSH, në zërat “FV pusetë plastike 40x40x40, kapak të fortë, çmimi”, “Shtresë asfaltobetoni”, “Spërkatje me emulsion bituminoz 1 lt/m²”, “Shtresë stabilizanti t=10 cm”, “Shtresë çakulli mbeturinë kave t=15 cm”, “Pllaka guri 40 x 40 cm ranor dhe gëlqeror për rrugë t=6-10 cm, çmimi”, “Gërmim dheu me krahë, kat IV, çmimi” dhe “Shtresë rëre nën dhe mbi tubacione”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. ..., datë 07.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe kontraktorit “**J.**” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,951,600 lekë pa TVSH**, nga kontraktori “**J.**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas Kontratës me nr. 1046, datë 07.05.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë, vlerë e cila përfaqëson, dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2.2.Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi” Bashkia Këlcyrë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 27,384,647 lekë, me kontraktor “**H.**” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,280,596 lekë pa TVSH në zërat e punës “Gërmim kanali tokë e zakonshme” dhe “Beton C16/20 veshje kanal betoni”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. ..., datë 01.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe kontraktorit “**H.**” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,280,596 lekë pa TVSH** nga kontraktori “**H.**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas Kontratës me nr. 1447, datë 01.07.2019, me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi” Bashkia Këlcyrë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3.2.Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën për ngritje kantier ndërtimi (investime publike), tarifë pastrimi për subjektet fituese të investimit deri në 5 milionë lekë, tarifë për ngritje kantier ndërtimi tarifë pastrimi për subjektet fituese të investimit mbi 5 milionë lekë, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Këlcyrë dhe Njësi Administrative në vartësi. Nga përlllogaritjet e kryera rezulton se nuk janë aplikuar tarifatat për kantier ndërtimi dhe pastrimi për 9 subjekte ndërtimi (sipas Tabelës nr.2.3.10 “Tarifat për subjektet me investime mbi 5 milionë lekë”, faqe 38 Raportit Përfundimtar të Auditimit), në vlerën totale prej 1,615,000 lekë. Vlera prej **1,165,000 lekë**, e cila përfaqëson mos arkëtim të tarifave për kantier ndërtimi dhe tarifë pastrimi, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues gjatë procedurave të prokurimeve publike, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e shumë prej **1,165,000 lekë** si rezultat i mos aplikimit të tarifave vendore për kantier ndërtimi dhe tarifatat e pastrimit për 9 subjektet që kanë kryer investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Këlcyrë.

4.2. Rekomandim: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë, të merren masat, që në çdo rast, subjektet përpara nisjes efektive të veprimtarisë, sipas vendndodhjes të objektit të kontratës, të kryejnë aplikimin për regjistrimin e hapjes së vendit të ushtrimit të veprimtarisë.

Menjëherë

4.3. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran Fushë, Rruga Goricë, Rruga Komarak e Vinokash, Rruga Gur Fshat Këlcyrë, Rruga Riban, Bashkia Këlcyrë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 36,353,317 lekë, me kontraktor “**H.**” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 591,263 lekë pa TVSH në zërat e punës “Strukturë monolite betoni C 16/20 për koka pusete”, “Strukturë monolite betoni C 12/15 me zgarë metalike 6 mm”, “Shtresë çakulli 15 cm” dhe “Shtresë çakulli mbeturinë kave t=10 cm, përhapur e ngjeshur me makineri”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. ..., datë 10.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe OE “**H.**” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **591,263lekë pa TVSH** nga kontraktori “**H.**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1304, datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran Fushë, Rruga Goricë, Rruga Komarak e Vinokash, Rruga Gur Fshat Këlcyrë, Rruga Riban”, Bashkia Këlcyrë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përllogaritjen e vlerës limit të kontratave, rezultoi se vlera limit e kontratës, për procedurën me objekt “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të Ujësjellësit Këlcyrë” është përllogaritur 803,300 lekë më shumë. Kjo për shkak se nga preventivuesi dhe Grupi i punës për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, i përcaktuar me Urdhrin datë 24.05.2019 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nuk është zbatuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime pika 3.1, për zërin e punimeve 2.197 “Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese katrama”. Për këtë zë punimesh sipas Manualit nr. 2, çmimi është 1,232 lekë/njësi, ndërsa nga preventivuesi dhe Grupi i punës është përllogaritur 12,312 lekë/m², pra 11,080 lekë/m² më shumë. Diferenca për gjithë sasinë është 803,300 lekë (72.5 m² * 11,080 lekë/m²=803,300 lekë). Nga auditimi i procedurës ka rezultuar se diferenca midis ofertës fituese dhe vlerës limit të kontratës është 449,700 lekë. Sa më sipër, diferenca në shumën 353,600 lekë midis vlerës së fondit limit të përllogaritur më tepër dhe diferencës së ofertës fituese kundrejt vlerës limit të kontratës, konsiderohet dëm ekonomik (803,300-449,700=353,600 lekë) dhe duhet të shpërblehet nga shkaktarët e këtij dëmi, Grupi i punës për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK), të marrë masa për arkëtimin e shumës prej **353,600 lekë**, nga z. **S. V.** dhe **B. I.**, si personat përgjegjës për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, referuar Urdhrit të Titullarit të AK, datë 24.05.2019 “Komisioni i ngarkuar për përllogaritjen e fondit limit”.

Menjëherë

6.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

D.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

*Nga verifikimi rezulton se Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 3 masë në vlerën **55,970,640 lekë**, të pranuar dhe të pa zbatuar, si vijon:*

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2019, detyrimet ndaj Bashkisë Këlcyrë, janë në vlerën gjithsej **60,386,981 lekë**. Kjo gjendje debitoare është krijuar nga **220** subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, për vlerën **22,853,022 lekë**, (e pa kontabilizuar), dhe **3,360** familje për detyrime të pa përllogaritura për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej **37,533,959 lekë**. Nga krahasimi i të dhënave midis vlerës së detyrimeve të pashlyera sipas të dhënave që disponon Sektori i Tatim Taksave Vendore, me vlerën që paraqet Sektori i Financës në pasqyrat financiare, (llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”) nuk paraqet vlerën reale të detyrimeve. Sipas bilancit të vitit 2018, detyrimet janë në shumën 6,078,000 lekë, e pandryshuar edhe në bilancin e vitit 2019, dhe sipas përllogaritjeve të bëra nga Grupi i Auditimit referuar të dhënave të marra nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, gjendja reale e debitorëve është në vlerën prej 60,386,981 lekë, pra konstatohet një diferencë e dukshme në vlerën prej **54,308,981 lekë**, vlerë kjo e cila është e pa kontabilizuar.

-Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave për 48 bizneset që rezultojnë me status pasiv, nuk janë mbajtur akt- konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit.

-Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 220 subjekte debitorë (fizik/juridik) në vlerën **22,853,022 lekë**, janë aktiv 172 subjekte ose 78% e totalit të debitorëve të evidentuar, të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa.

Sektori i Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, ka zbatuar vetëm procedurën e bllokimit të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe **asnjë procedurë tjetër**, ku dhe kjo procedurë që në fillimet e saj rezulton e dështuar, sidomos për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë të deklaruar pranë sektorit të taksave nr. llogarie bankare, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo nëpërmjet bankës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi:Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë të marrë masat për të ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, **për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 220 subjekte për vlerën 22,853,022 lekë dhe 3,360 familje për vlerën gjithsej 37,533,959 lekë**, bazuar në neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor” ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime ne llogarit bankare;
- T'i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe “Sektori Juridik”, të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

- Menjëherë

1.1.Nga verifikimi rezulton se:Bashkia Këlcyrë janë krijuar debitorë, të cilët në datën 31.12.2021 kanë vlerën progresive 69,567 mijë lekë e pa kontabilizuar në financë në mënyrë të detajuar paraqiten si vijon: -Biznesi në vlerën 20,231 mijë lekë; -tokë bujqësore në vlerën 42,138 mijë lekë;-taksa tarifa familjare në vlerën 7,198 mijë lekë.

Vlera e borxhit të vitit në 31.12.2021 është në vlerën 7,465 mijë lekë nga të cilat Biznesi në vlerë 1,298 mijë lekë; Familjet tarifa në vlerën 1,399 mijë lekë; Familjet tokë në vlerën 4,768 mijë lekë.

Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, **në 6 procedura**, sipas Tabelës anekse nr. 4.5 “Efektet financiare”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, si rezultat i vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me aktet rregullative, është shkaktuar përdorim i fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë, **në shumën 23,967,868 lekë**. Efektet negative, janë shkaktuar si rezultat i kualifikimit të Operatorëve Ekonomikë (OE) të shpallur fitues, në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. OE, janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DT, të hartuara nga Njësia e Prokurimit e të miratuara nga Titullari i AK, duke mos garantuar përmbushjen me cilësi të

kontratës, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të vendosura në DT. Diferenca midis OE me ofertën më të ulët dhe OE të shpallur fitues, në kushtet kur asnjë prej tyre nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, është konsideruar paligjshmëri në prokurimin e fondeve publike, me pasojë përdorim pa efektivitet ekonomikitet dhe efijencë të fondeve publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Këlcyrë, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë nga ana e KVO-së, të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në DT, për përmbushjen e “Kriterëve të veçanta për kualifikim”, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të cilat janë në kundërshtim me aktet rregullative të fushës, si dhe me pasojë në përmbushjen me cilësi të kontratës në këto investime, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të vendosura në DT.

Menjëherë

2.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, konstatojmë se ka mospërputhje të theksuar midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar, sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se, Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në Bashki, për të grumbulluar evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave. Sipas të dhënave të paraqitura nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se planifikimi i taksës së tokës bujqësore për dy vitet 2018 dhe 2019, është në shumën 4,950,000 lekë dhe për vitin 2020 në shumën 1,417,000 lekë, ndërsa referuar të dhënave të Sektorit të Bujqësisë në Bashkinë Këlcyrë, planifikimi për vitet 2018 dhe 2019, duhej të ishte në shumën 10,854,000 lekë dhe për vitin 2020 duhej të ishte në shumën 5,904,500 lekë. Sa më sipër, rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, është planifikuar më pak e ardhura nga këto taksa e tarifa për vlerën 9,914,750 lekë, në kundërshtim me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Projekt Raportit të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të Sektorit të Bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, në shumën prej **9,914,750 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë.

Menjëherë

3.2. Nga verifikimi rezultoi se Në zbatim të rekomandimeve të dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021, ka dal urdhëri nr. 440 prot datë 25.02.2022 i cili ka ngarkuar personat konkret për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmar asnjë procedurë.

Pa zbatuar

E. MASA ADMINISTRATIVE

E.1. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësive individuale të evidentuara dhe pasqyruara në dokumentet e auditimit (Aktkonstatime, Projektraport Auditimi dhe Raport Përfundimtar Auditimi), mbështetur në nenet 13 “Agjencia e Prokurimit

Publik” dhe 72 “Kundërvajtjet administrative” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 germa (c) dhe (ç), si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me këto shkelje, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për 3 punonjës. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 82 datë 24.11.2021 ka vendosur masë Administrative për 4 persona në vlerën 320,000 lekë. Nga verifikimi rezulton se Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk ka ndërmarr asnjë veprim në zbatim të vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, protokolluar në Bashkinë Këlcyre me shkresën nr. 2784 prot datë 26.11.2021.*

Masat administrative gjobë, vendosur nga APP me Vendimin nr. 82 datë 24.11.2021

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni Zyrtar	Rekomandimi i KLSH dhe I APP	Masa e zbatuar	
				Shkresa apo vendimi nr data	Lloji i masës së zbatuar
1	A. Q.	Specialis zyra e Tatim Taksave Nj. Administrative Ballaban.	100,000	Vendimi 82 datë 24.11.2021	Pa zbatuar
2	R.H.	Sekretare e Përgjithshme	100,000	Vendimi 82 datë 24.11.2021	Pa zbatuar
3	E. L.	Punonjës në policin Bashkiake	70,000	Vendimi 82 datë 24.11.2021	Pa zbatuar
4	A. L.	Specialist për Kadastrën	50,000	Vendimi 82 datë 24.11.2021	Pa zbatuar

Burimi: Vendimi i APP

1. Z. A. Q., Për shkeljet e konstatuara në 9 procedura prokurimi me objekt “Punë publike”, dhe “Blerje mallrash”, Nga verifikimi rezultoi se APP me vendimin nr. 82 datë 24.11.2021 ka vendosur masë administrative me gjobë në vlerë 100,000 lekë

2. Znj. R.H., në cilësinë e anëtares së KVO-së, në 9 procedura prokurimi me objekt “Punë publike”, dhe “Blerje mallrash”, Nga verifikimi rezultoi se APP me vendimin nr. 82 datë 24.11.2021 ka vendosur masë administrative me gjobë në vlerë 100,000 lekë

3. Z. E. L., në cilësinë e anëtarit të KVO-së, në 6 procedura prokurimi me objekt “Punë publike”, dhe “Blerje mallrash”, Nga verifikimi rezultoi se APP me vendimin nr. 82 datë 24.11.2021 ka vendosur masë administrative me gjobë në vlerë 50,000 lekë

E.2. Shkeljet e konstatuara në hartimin e Projekt Buxheteve Afatmesme (PBA) dhe buxheteve vjetore, mangësitë e theksuara në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në mosfunksionimin e njësisë së auditit të brendshëm, mungesën e procedurave për mirë administrimin e aseteve, për periudhën objekt auditimi, përbëjnë shkelje nga ana e **Z. K. N.**, në cilësinë e Titullarit të Njësisë Publike, Bashkia Këlcyre, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime, Kreu II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1 Sa më sipër, bazuar në Kreu V “Dispozita të fundit dhe kalimtare”, neni 29 “Kundërvajtjet administrative” dhe në nenin 15 germa (c) dhe (ç), si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Nëpunësit të Parë Autorizues**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me këto shkelje.

Nga verifikimi rezultoi se deri në momentin e verifikimit nuk është marrë asnjë masë ndaj Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

F. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuara në ligje të veçanta.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37 “Masa disiplinore” të Kodit të punës në Republikën e Shqipërisë, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë, që të vlerësojë shkeljet dhe masën disiplinore për punonjësit si më poshtë:

Sipas urdhrit të pashët cituar Kryetari i Bashkisë ka vendosur masë disiplinore “Vërejtje” sipas rekomandimeve të KLSH, për 6 persona si me poshtë:

1. Znj. V. K., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës dhe Buxhetit, si dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për shkeljet e konstatuara në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportimin financiar për vitet 2018 dhe 2019. Nga verifikimi rezultoi se me vendimin nr. 110/1 date 14.01.2022 komisioni disiplinor ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, dokument i cili është vendosur në dosjen personale të punonjësit.

2. Znj. R. H., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në mos evidentimin e subjekteve taksapaguese (fizike/juridikë); mos planifikim real të të ardhurave; mos menaxhim të duhur dhe efikas të këtij sektori në drejtim të vjeljes së të ardhurave, ndjekjes së debitorëve, etj. Nga verifikimi rezultoi se me vendimin nr. 110 date 14.01.2022 komisioni disiplinor ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, dokument i cili është vendosur në dosjen personale të punonjësit.

3. Z. H. S., z. B. A., z. V. K. dhe znj. L. P., në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Blerjeve të Vogla, për shkelje të procedurave të përcaktuara në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Udhëzimin e APP-së nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Nga verifikimi rezultoi se me vendimin nr. 472, 472/1, 472/2 datë 01.03.2022 komisioni disiplinor ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për të tre punonjësit, dokument i cili është vendosur në dosjen personale të punonjësit.

Përmbledhëse e Masave Disiplinore dhe Administrative

Mbështetur në ligjin “Për statusin e Nëpunësit Civil”, nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

Nr	Lloji i masës rekomanduar nga KLSH	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar
a	b	1	2	3
1	Pezullimi nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet	0	0	0
2	Vërejtje me shkrim	6	6	0
	Gjithsej	6	6	0
3	Gjopa IMTV			
4	Gjopa APP	3	0	3
	Gjithsej	9	6	3

Sa sipër nga 6 masa të rekomanduara gjithsej nga KLSH, rezulton se janë zbatuar 6, masa disiplinore. Nga tre masa të propozuara APP, me vendimin 82 datë 24.11.2021 janë vendosur 4 masa, të cilat nuk janë zbatuar.

Zbatimi i rekomandimeve për Bashkinë Këlcyrë (Formulari nr. 12)

			Nga këto:	Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike
--	--	--	------------------	---

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Pranuar në numër	Zbatuar në numër	Zbatuar pjesërisht numër	Pa zbatuar në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar/ apo proces zbatimi		Ne Proces Civil apo Penal ne 00/lek	Pazbatuar (Pa fill proced)	
							Nr. pers	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë		Nr. pers	Në 000/lekë
a	b														
I.	Në fushën e legjislacionit	2	2												
1	Shfuqizim akti														
2	Përmirësim akti														
II.	MASA ORGANIZATIVE (Gjithsejt, Ne vlere)	22	22			22									
III.	MASA SHPERBLIM DEMI	6	6			6	6	16,342						6	16,342
	(Nga te cilat nuk janë kontabilizuar, ne Finance)														
IV.	MASA DISIPLINORE	6	6	6	0	0									
	(Nga te cilat nuk jane nxjere urdhrat, vendimi)	0	0	0	0	0									
V.	MASA ADMINISTRATIVE	3	4			4	4	320						4	320
	Nga të cilat:														
	Gjobat e Inspektoriateve														
	(Nga te cilat nuk jane kontabilizuar ne Financë)														
	Gjobat e APP														
	(Nga të cilat nuk janë kontabilizuar ne Financë)														
VI.	Dhe të tjera masa nëse ka. Gjoba APP														

Burimi: Vendimi i Kryetarit të KLSH-së

IV- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për shkeljet e konstatuara në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 612/10 datë 12.04.2021, rezulton se nga **37** masa të rekomanduara (organizative, shpërblim dëmi, 3-E, mungesë të ardhurash dhe disiplinore), janë pranuar nga subjekti në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar dhe në proces zbatimi, gjithsej **6** masa ose 16% e masave të rekomanduara dhe nuk janë zbatuar akoma **31** masa ose 84 % e masave të rekomanduara.

Nga sa shikohet niveli i realizmit është nën 2% gjë e cila tregon se Bashkia Këlcyrë nuk e ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Sa më sipër, bazuar në nenin 15 germa (c) dhe (ç), si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” ngarkohet me përgjegjësi **z. K. N.**, në cilësinë e Titullarit të Njësisë Publike, Bashkia Këlcyre, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime, Kreu II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1.

Në përfundim të procesit të auditimit në Bashkinë Këlcyrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 612/10 datë 12.04.2021, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre është e pazbatuar, duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si vijon

C. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Këlcyrë 22 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht referuar urdhrat të titullarit me nr. 440 prot datë 25.02.2022 të cilat nuk janë zbatuar, si vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, si dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, nuk paraqesin drejtë gjendjen e tyre në fund të viteve ushtrimore 2018 dhe 2019.

Sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2018, ka rezultuar që llogaria 212 “Ndërtime dhe rikonstruksione” është rritur për shumën 6,675,337 lekë dhe llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është rritur për shumën 150,447,389 lekë, ndërsa sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2019, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është rritur për shumën 66,600,470 lekë.

Sipas dokumentacionit të verifikuar, këto vlera përfaqësojnë shpenzime kapitale, të papërfunduara, të pa kolauduara dhe të pa marra në dorëzim nga Bashkia Këlcyrë, ç’ ka do të thotë, se janë investime në proces dhe jo investime të kapitalizuara. Për rrjedhojë regjistrimi i tyre në kontabilitet, në debi të llogarive 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe jo në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.2. Rekomandimi: Nga ana e Përgjegjëses së Zyrës së Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë, të bëhen sistemimet kontabël si më poshtë:

- Sistemim në kontabilitet i llogarisë 212 “Ndërtime e Konstruksione” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” për shumën **6,675,377 lekë**, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit pasardhës, duke bërë veprimin kontabël në debi të llogarisë 231 dhe kredi të llogarisë 212;

-Sistemim në kontabilitet i llogarisë 213 Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” për shumën **150,477,389 lekë** në vitin 2018 dhe **66,600,470 lekë** për vitin 2019, në debi të llogarisë 231 dhe në kredi të llogarisë 213.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i analitikëve të llogarisë 202 “Studime e kërkime” konstatohet se, gjendja në fund të vitit 2018 dhe vitit 2019, për nëntë studime e projektme, të trashëguara nga Njësia Ballaban, paraqitet në vlerën zero lekë, (sipas Tabelave anekse nr. 3.2 dhe 3.3 “Studime dhe projektme të pa kontabilizuara”, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).Kjo situatë ka sjellë që AAGJMM, të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (llogaria 230 “Studime dhe kërkime”) të mos paraqesin “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Këlcyrë, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi. Duke qenë se këto aktive të trashëguara janë paraqitur me vlerë zero, nuk janë bërë hyrje në magazinë.

Gjithashtu, është evidentuar se disa AAGJM, si “Ndërtesa e konstruksione”, (sipas Tabelave anekse nr. 3.4 dhe 3.5, trajtuar faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit) në fund të vitit 2019, janë paraqitur me vlera të ulëta (nën 100,000 lekë), vlera këto, jo reale në krahasim me vlerat e tregut për aktivet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2019, pika 105.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Këlcyre, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë, Nëpunësit Autorizues si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për vlerësimin e aktiveve jo materiale, bërjen hyrje në magazinë të tyre, si dhe rivlerësimin e aktiveve materiale, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, për vitet 2018 dhe 2019, nuk janë përfshirë në inventarizim llogaritë: 210 “Toka, troje, terrene”; 211 “Pyje Plantacione”; 212 “Ndërtesa e Konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”; 215 “Mjete transporti” dhe aktivet afatshkurtra, si dhe për këto llogari, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, me të dhënat mbi, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e s’ kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Gjithashtu, është evidentuar se për vitin 2018, nuk është kryer inventarizimi i aktiveve, si dhe nuk disponohet asnjë dokumentacion, Urdhër i Kryetarit, për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2018.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Këlcyrë, konkretisht:

- Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s’ kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
- Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Këlcyrë, sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), më datë 02.11.2016 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime SHA, Këlcyrë, e cila është shoqëri aksionere me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij...”. Numri i aksioneve është 1,00 me vlerë nominale 21,259,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 21,259,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Këlcyrë, në Ujësjiellës Kanalizime SHA, Këlcyrë, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Pasqyrës së Pozicionit Financiar të viteve 2018 dhe 2019, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 64, datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. Mos pasqyrimi i vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 21,259,000 lekë, në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, përbën deformim të informacionit financiar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të Ujësjiellës Kanalizime SHA, Këlcyrë, me vlerë kontabël **21,259,000 lekë**, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në fund të viteve ushtrimore 2018 dhe 2019, gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” është në vlerën 6,078,720 lekë, e cila analitikisht përfaqëson debitorë për penalitete dhe kamatëvonesa, vlerë e cila nuk është e saktë. Në asnjë rast, nuk janë evidentuar në llogaritë analitike si për vitin 2018 dhe 2019, debitorët për taksat dhe tarifave vendore. Sipas rakordimit me zyrën e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Këlcyrë, detyrimet e evidentuara për vitet 2018 dhe 2019, janë dërguar me shkresat përcjellëse me nr. 259, datë 01.02.2019 për vitin 2018 dhe nr. 331, datë 14.02.2020, për vitin 2019, Zyrës së Financës dhe sipas tyre, detyrimi paraqitet në vlerën 53,051,426 lekë në vitin 2018 dhe 60,386,981 lekë për vitin 2019. Për rrjedhojë nuk është pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe në kundër partinë llogaritë e klasës 7, vlera prej 53,051,426 lekë për vitin 2018, dhe vlera prej 60,386,981 lekë për vitin 2019, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke e debituar për vlerën 53,051,426 lekë për vitin 2018 dhe 60,386,981 lekë për vitin 2019. Gjithashtu, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifave vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit” të vitit në vazhdim.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” paraqitet në shumën 6,714,053 lekë për vitin 2018 dhe 7,622,212 lekë për vitin 2019. Në mënyrë analitike kjo llogari ka përfshirë në debi, gjendjet e llogarive kreditore të detyrimeve 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” dhe 435 “Sigurime Shoqërore” për secilin vit përkatës. Nga ana tjetër janë analizuar dhe kontratat e investimeve si dhe financimi i këtyre angazhimeve sipas PBA-së 2017-2018-2019, trajtuar në Tabelën anekse nr. 3.6 “Mbi financimin e pritshëm nga buxheti”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për sa i përket të drejtave që i lindin subjektit Bashkia Këlcyrë, për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit, në lidhje me këto angazhime të ndërmarra, gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019, konstatohet se bazuar në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 32 e tij, ky kontabilizim nuk është bërë, gjë që ka sjellë mos pasqyrimin e detyrimeve të buxhetit kundrejt Bashkisë Këlcyrë, për shumën 69,955,690 lekë në vitin 2018 dhe për shumën 237,523,073 lekë në vitin 2019, në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për shumën 69,955,690 lekë për vitin 2018 dhe për shumën 237,523,073 lekë për vitin 2019. Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2020.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, pas analizimit të të gjitha kontratave të lidhura për investime kapitale, sipas Tabelës anekse nr. 3.7 “Detyrimet e prapambetura” faqe nr. 58 e Raportit Përfundimtar të Auditimit, paraqitja e detyrimeve të prapambetura në kontabilitet, nuk është vlerën e saktë.

Në Bilancin Kontabël për vitin 2018 dhe 2019 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe kundër partia 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vitin 2018 në vlerën 386,712 dhe për vitin 2019 në vlerën 630,628 lekë, ç’ ka do të thotë se, detyrimi i prapambetur lindur nga shpenzimet kapitale në vitet 2018 dhe 2019, nuk është pasqyruar. Kjo ka sjellë, mos pasqyrimin e saktë të gjendjes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën 6,052,070 lekë, për vitin financiar të mbyllur 2018 dhe 4,335,775 lekë, për vitin financiar të mbyllur 2019.

Këto llogari, gjithashtu nuk paraqesin drejtë gjendjen e tyre për vitin 2019, për shkak edhe të mos njohjes së detyrimit që ka lindur në vitin 2019 (referuar datës së faturës), por që janë likuiduar (lëvizja cash) në vitin 2020, për vlerën 20,109,193 lekë.

Në rastet e mësipërme, është shkelur një nga parimet kryesore të kontabilitetit “të drejtat dhe detyrimet e konstatuara”, pra evidentimi i shpenzimeve në kontabilitet në momentin kur ndodh ngjarja.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi:

- Nga Bashkia Këlcyre, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën **6,052,070 lekë**, diferencë e vitit financiar të mbyllur 2018 dhe **4,335,775 lekë** diferencë e vitit financiar të mbyllur 2019, si dhe të sistemohet në kontabilitet vlera prej **20,109,193 lekë** e faturave të cilat janë likuiduar në vitin 2020, por që detyrimi ka lindur në vitin 2019, në llogaritë përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

- Nga ana e Bashkisë Këlcyre, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e kryerjes së shpenzimeve, me objekt investimet kapitale të vitit 2018 dhe 2019 rezultoi se, në përgjithësi faturat tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimeve, kanë datë lëshimi të mëvonshme nga data e situacionit përkatës. Paraqitja e faturave tatimore, në data të mëvonshme nga datat e situacioneve të punimeve, është në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, gjë për të cilën parashikohet penalitet për investitorët, për mospagim në afat të TVSH-së, i cili arrin vlerën e 455,084 lekë, sipas Tabelës anekse nr. 3.1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Kjo shumë konsiderohet një e ardhur (jo tatimore) e munguar në buxhetin e shtetit.

Nga auditimi i transaksioneve lidhur me shpenzimet e investimeve, për periudhën objekt auditimi, janë evidentuar raste, ku dokumentacioni i paraqitur për justifikimin e shpenzimeve, ka rezultuar i paplotë, konkretisht janë paraqitur nga investitorët situacione pa data. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7, 12, dhe 18 si dhe UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Gjithashtu, pranimi i dokumentacionit vërtetues të parregullt dhe të pa plotë, është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4, pika 26, me neni 6 të UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 35 dhe 36, është përgjegjësi e nëpunësit zbatues.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues i Bashkisë Këlcyrë, të merren masa që likuidimi i shpenzimeve të kryhet bazuar në dokumentacion të plotë, autorizues dhe vërtetues të shpenzimit kapital. Nga Nëpunësi Autorizues të dërgohet shkresë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, ku të vihet në dijeni për gjendjen e debitore të subjekteve “R.” SHPK me NIUS J.....E dhe “B.” SHPK, me NIUS K.....A, shkaktuar si rezultat i mospagimit në afat të TVSH-së, në vlerën **455,084 lekë**.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hartimin e Programeve Buxhetore Afatmesme (PBA) ka rezultuar se Bashkia Këlcyrë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36 dhe 37; UMF nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, shtojca 5; UMF nr. 22, datë 30.07.2017 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, shtojca 1; UMF nr. 6/3, datë 10.07.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor” dhe UMF nr. 7, datë 27.02.2019 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022”, kapitulli 1.

Mbi programimin e PBA-së 2018-2020; 2019-2021 dhe 2020-2022 është konstatuar se:

- Nga ana e Titullarit të Institucionit, nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS);
- Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor brenda muajit dhjetor të viteve paraardhëse;
- Nga Kryetari i Bashkisë nuk është paraqitur për shqyrtim dhe miratim raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve brenda datës 15 Mars (të vitit paraardhës);
- Nuk janë miratuar nga Këshilli Bashkiak, vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Nuk janë organizuar seanca dëgjimore me qytetarët si dhe nuk është prezantuar dokumenti i PBA me shoqërinë civile;
- Nuk është dërguar brenda datës 1 Qershor 2017 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dokumenti i programit buxhetor afatmesëm (PBA 2018-2020);
- Nuk janë miratuar në Këshillin Bashkiak, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (të vitit paraardhës);
- Nga Njësitë shpenzuese të Bashkisë, nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore të rishikuara, si dhe nga Njësia Përgjegjëse për buxhetin në Bashkinë Këlcyrë, nuk janë kryer analizat e kërkesave buxhetore;
- Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak programi buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxhetin vjetor brenda datës 25 dhjetor (të vitit paraardhës).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Projekt Raportit të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Këlcyre, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues dhe Kryetarit të GMS-së, si dhe Nëpunësi Zbatues, për zbatimin e të gjitha procedurave ligjore, për programimin e buxheteve vjetore dhe afatmesme, duke krijuar grupet e punës sipas projekteve të financimit, duke ndjekur dhe zbatuar kalendarin e programimit të buxhetit, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se treguesit buxhetor të planifikuar dhe miratuar për periudhën objekt auditimi, paraqiten në nivele të ulëta realizimi. Kështu, është evidentuar nivel i ulët i realizimit të planit të të ardhurave, ku për vitin 2018, paraqiten me realizim në masën 67 % kundrejt planit dhe për vitin 2019, paraqiten me realizim në masën 51 % kundrejt planit.

Viti	Të ardhura të veta-000/lekë				Shpenzimet buxhetore-000/lekë			
	Plan	Fakt	Diferenca	%	Plan	Fakt	Diferenca	%

2018	19,386	13,115	-6,271	67	394,861	363,438	-31,423	92
2019	20,047	10,290	-9,757	51	378,868	356,362	-22,506	94

Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta, gjë e cila ka ndikuar në mosrealizim të shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë, duke shtuar riskun për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e Titullarit dhe të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, duhet të marrin masa, që gjatë procesit të planifikimit të PBA-ve dhe buxheteve vjetore, të mbështeten në analiza të hollësishtme mbi kapacitetet ekonomike, financiare dhe resurset e territorit nën administrim, për një planifikim sa më objektiv dhe real të të ardhurave, me qëllim mos krijimin e diferencave të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të buxhetit, gjë e cila shoqërohet me marrje angazhimesh për kryerje shpenzimesh, si dhe mos likuidim të tyre për shkak të mungesës së likuiditetit.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Këlcyrë ka trashëguar dhe ka krijuar detyrime të prapambetura për periudhën objekt auditimi, të cilat nuk kanë gjetur pasqyrim real në planifikimin e buxheteve vjetore, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe udhëzimet standarde për zbatimin e buxheteve të njësisve të qeverisjes së përgjithshme, konkretisht:

- Në vitin 2017, është prokuruar objekti: “Rijetëzim i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin qendër” me vlerë 148,783,112 lekë me TVSH, me burim financimi nga FZHR, ku likuidimi i këtij investimi në 31.12.2017 paraqitet në vlerën 37,227,210 lekë dhe likuidimi në 31.12.2018 paraqitet në vlerën prej 107,222,064 lekë. Detyrimi i mbetur për vitin 2018 dhe 2019 është në vlerën prej 4,333,838 lekë, detyrim i cili nuk është planifikuar në PBA 2018-2020 si dhe në Planin e buxhetit të vitit 2019.

- Në vitin 2018, është prokuruar objekti: “Rikonstruksion i urës në qendër të qytetit Këlcyrë” me vlerën 4,943,420 lekë me TVSH, me burim financimi nga të ardhurat e veta, ku likuidimi i këtij investimi në 31.12.2018 paraqitet në vlerën 3,240,550 lekë. Detyrimi i mbetur për vitin ushtrimor 2018 është në vlerën prej 1,702,870 lekë, detyrim i cili nuk është planifikuar në PBA 2018-2020 si dhe në Planin e buxhetit të vitit 2019.

- Në vitin 2018 rezulton se, vendimi gjyqësor i lindur si detyrim në Bashkinë Këlcyrë, me nr. ekzekutimi 64 datë 14.11.2018, me vlerë 150,000 lekë, nuk është njohur si detyrim në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018, si dhe nuk paraqitet si detyrim në Planin e Buxhetit të vitit 2019 dhe PBA 2019-2021.

- Në vitin 2019 rezulton se, vendimi gjyqësor i lindur si detyrim në Bashkinë Këlcyrë me nr. ekzekutimi 1249 datë 28.10.2019, me vlerë 429,000 lekë, nuk është njohur si detyrim në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2019, si dhe nuk paraqitet si detyrim në Planin e Buxhetit të vitit 2020 dhe PBA 2020-2022.

- Gjithashtu, është konstatuar se në vitin 2019, është prokuruar objekti “Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit” me vlerë 34,858,247 lekë me TVSH dhe objekti “Sistemi asfaltim rruga Sukë Podgoran” me vlerë 36,353,317 lekë me TVSH, me burim financimi nga të ardhurat e Bashkisë, pa miratuar si objekt në Këshillin e Bashkisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandimi:

- Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit dhe Nëpunësit Autorizues, si dhe Nëpunësi Zbatues, duhet të marrin masa që gjatë procesit të planifikimit të buxheteve vjetore, të planifikojë mbulimin me buxhet, së pari për detyrimet e papaguara dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.

- Gjatë zbatimit të buxheteve vjetore, për investimet që financohen nga të ardhurat e veta të merret paraprakisht miratimi në Këshillin Bashkiak, të zbatohen të gjitha procedurat ligjore bazuar në udhëzimet vjetore dhe standarde të planifikimit dhe zbatimit të buxheteve vjetore.

Menjëherë

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi subjektet, që ushtrojnë aktivitet në shtrirjen territoriale administrative të Bashkisë Këlcyrë të regjistruara në QKB (referuar të dhënave të Tabelës nr. 2.3.2 “Gjendja e subjekteve të regjistruara”, faqe 30 e RPA), konstatohen se për vitet objekt auditimi, ka 5 regjistrime të reja dhe 45 subjekte mbyllje aktiviteti, nga të cilat: Për vitin 2018, kanë ushtruar aktivitet 201 subjekte (184 subjekte të biznesit të vogël, 17 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera e institucione), për vitin 2019, kanë ushtruar aktivitet 163 subjekte (142 subjekte të biznesit të vogël, 21 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera e institucione).

Kjo situatë faktorizohet jo vetëm nga niveli i ulët ekonomik i Bashkisë Këlcyrë, por dhe nga puna e pa mjaftueshme e strukturave të Sektorit të Tatim Taksave, pasi:

- Nuk janë mbajtur regjistra manual për bizneset që ushtrojnë aktivitet tregtar etj, për të rritur sigurinë e informacionit që disponojnë, nisur nga fakti se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon program kompjuterik të licencuar dhe të mbrojtur.
- Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe kontrollit fizik të dokumentacionit rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, nuk është administruar në dosjet e bizneseve që janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, deklarata tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore.
- Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe auditimi fizik i dokumentacionit, rezulton se nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk është marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, mbi xhiron e subjekteve, ku mbi bazën e këtyre të dhënave aplikohen dhe taksat vendore sipas llojeve të biznesit (fizik/juridik).
- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se, 36 subjekte të biznesit të vogël, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në Bashkinë Këlcyrë dhe Njësitë Administrative, Sukë, Ballaban, Dishnice, nuk janë regjistruar në QKB, kjo ngarkon me përgjegjësi Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, i cili nuk ka ndërmarrë veprimet ligjore për detyrimin e këtyre subjekteve që të regjistrohen në QKB, por është mjaftuar vetëm me evidentimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 41 dhe nenin 121, pika 1 germa b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi:

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që deklarojnë mbyllje aktivitet, nëse deklarimi është i saktë si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të peregjistruar në QKB.
- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, duhet të marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar numrin e subjekteve fizik/juridik si dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara të bëhet aplikimi i taksave dhe tarifave vendore.

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi aktivitetin e agjentëve tatimorë për të ardhurat që arkëtohen dhe kalojnë në Bashkinë Këlcyrë, u konstatua se nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore, midis Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë dhe Agjentëve Tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja Dega Gjirokastër, nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji (brenda datës 5 të çdo muaji), për llogari të Bashkisë Këlcyrë nisur nga fakti se, në vitet 2018 dhe 2019 nuk ka asnjë arkëtim. Rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, në lidhje me Tatim Fitimin e

Thjeshtuar, nuk janë mbajtur rregullisht në fund të çdo muaji dhe nuk ka informacion sa subjekte duhet të paguajnë dhe sa jo, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 70 pika 3.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi:

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimorë, sipas llojit të taksës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë, si dhe të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë.
- Të krijohet baza e të dhënave për subjektet, tarifatat dhe taksat të cilat mbledhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzohet informacionet me institucionet e tjera dhe të kryejë rakordimet në fund të çdo muaji, sipas formularit përkatës, të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është evidentuar realizim i ulët i të ardhurave dhe shpenzimeve nga ana e Bashkisë Këlcyrë, gjë e cila flet për punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre, ku si rezultat i mos arkëtimeve, sjell si pasojë që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2018 dhe në buxhetin e vitit 2019, të mbeten pa burim financimi, duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe borxhin. Konkretisht:

- Për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga 19,386,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 13,115,000 lekë, **ose 68 % me një diferencë në vlerën 6,271,000 lekë.**
- Për vitin 2019, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga 20,047,000 lekë të parashikuara, janë realizuar, në vlerën 10,290,000 lekë, **ose 51%, me një diferencë në vlerën 9,757,000 lekë.**
- Niveli i arkëtimeve për taksat vendore nga njëra periudhë në tjetër vjen në ulje, ku për vitin 2018, paraqitet në shumën 13,115,000 lekë, ndërsa në vitin 2019 paraqitet në shumën prej 10,290,000 lekë **ose më pak në shumën prej 2,825,000 lekë ose 12% më pak.** Kjo tregon punë pamjaftueshme të administratës së tatim taksave të Bashkisë Këlcyrë në menaxhimin e të ardhurave si në fazën e planifikimit po ashtu dhe të realizimit të tyre.
- Mos evidentimi dhe regjistrimi i debitorëve realë, nga Zyra e Financës, mos arkëtimi i detyrimeve debitorë, gjithashtu ka sjellë mungesë të ardhurash për Bashkinë Këlcyrë.
- Përsa më sipër, faktorët që kanë ndikuar në realizimin e të ardhurave janë:
- Nga të dhënat ka rezultuar se, nuk është mbajtur akt-rakordim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimor.
- Gjithashtu dhe në fazën e planifikimit nuk është marrë në konsideratë numri i subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën e të dhënave për subjektet të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore, do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.
- Nga verifikimi rezulton se, nuk është rakorduar (çdo 6-muaj) me Drejtorinë e Tatimeve të Qarkut Gjirokastrë, për realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, në cilësinë e agjentit tatimor.
- Të ardhurat nga taksat kombëtare, për vitin 2018, nuk janë planifikuar, kjo tregon për mos njohje të burimeve dhe resurseve që ka Bashkia Këlcyrë, si dhe mos njohja e kuadrit ligjor që rregullon përfitimin e njësive vendore nga këto taksa.

- Taksa e mjeteve të përdorura, është planifikuar sipas të dhënave historike, pra nuk ka një data bazë të saktë, për numrin e mjeteve në përdorim që gjenden në territorin e Bashkisë Këlcyrë.
- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e taksave të popullatës është mjaftuar vetëm duke detyruar familjet që marrin shërbim (vërtetime etj.) në Bashkinë Këlcyrë, të paguajnë tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
- Nga auditimi rezulton se nuk është kryer rakordim me zyrat e gjendjes civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Këlcyrë.
- Realizimi i të ardhurave nga arkëtimi i detyrimeve të debitorëve të ndryshëm është në shumën 0 lekë, për të dy vitet objekt auditimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis sektorëve dhe bashkëpunimin me struktura të tjera si: Qendrën Kombëtare të Biznesit, Drejtorinë e Tatimeve Gjirokastër, Zyrën e Gjendjes Civile, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, etj. me qëllim:

- Kryerjen e rakordimeve me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, (në cilësinë e agjentit tatimor) për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë, si dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimor, si dhe kryerjen e rakordimeve 6-mujore mbi realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;
- Marrjen e të dhënave mbi bizneset në QKB, që në fazën e planifikimit, mbi numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën e të dhënave për subjektet, të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore, do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;
- Marrjen e masave për evidentimin e resurseve, analizimin dhe planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare;
- Marrjen e masave për kryerjen e rakordimeve me Zyrën e Gjendjes Civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Këlcyrë, si dhe marrjen e masave për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 1304, datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim Rruga “Sukë Podgoran Fushë”, Rruga “Goricë”, Rruga “Komarak e Vinokash”, Rruga “Gur Fshat Këlcyrë” dhe Rruga “Riban””, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1046, datë 07.05.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor është miratuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve 1.7-2.5 herë më shumë, se afati fillestar i përfundimit të punimeve, pa patur asnjë argument teknik të besueshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa, për nxjerrjen e përgjegjësive në rastet e shtyrjes së afatit të zbatimit të kontratave në mënyrë të pa argumentuar teknikisht, si dhe për ndjekjen në kohë të zbatimit të kontratave, në mënyrë që të respektohet afati i përfundimit të punimeve, duke aplikuar penalitete për kontraktorin në rast të shkeljes së afatit, si dhe për vënien e objekteve në kohë në efikasitet të plotë, për arritjen me sukses të impaktit tek qytetarët.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 1304, datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim Rruga “Sukë Podgoran Fushë”, Rruga “Goricë”, Rruga “Komarak e Vinokash”, Rruga “Gur Fshat Këlcyrë” dhe Rruga “Riban””, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1447, datë 01.07.2019, me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi”, Bashkia Këlcyrë, nuk administrohej leja e ndërtimit, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 39, “Leja e ndërtimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa që para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 1304, datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim Rruga “Sukë Podgoran Fushë”, Rruga “Goricë”, Rruga “Komarak e Vinokash”, Rruga “Gur Fshat Këlcyrë” dhe Rruga “Riban””, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1447, datë 01.07.2019, me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi”, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1046, datë 07.05.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë, rezultuan diferenca në volume dhe për pasojë dëm ekonomik, ndërkohë që vlera e kontratave të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve ishin të gjitha 0 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të analizohen shkaqet që kanë shkaktuar diferenca në volume gjatë zbatimit të punimeve në këto objekte dhe në rast të neglizhencës së mbikëqyrësve dhe kolaudatorëve, për shkak të dhënies së shërbimit pa kosto, të merren masa që të vlerësohet kostoja e këtyre shërbimeve, sipas legjislacionit në fuqi dhe të bëhet prokurimi i këtyre fondeve, me qëllim kryerjen e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve me përgjegjësi të lartë profesionale.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe miratimin e DT, u evidentuan mangësitë e mëposhtme:

-Në "Kriteret e veçanta për kualifikim", përsa i përket numrit të punonjësve dhe stafit teknik, që duhet të disponojë operatorët ekonomikë për realizimin e kontratës, nga ana e NJP në asnjë prej procedurave, nuk është dhënë asnjë argument, mbi përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve dhe të stafit teknik, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2;

- Përsa i përket përmbushjes së kriterit mbi punët e të njëjtës natyrë apo ngjashme të realizuar në sektorin privat, në të gjitha procedurat, është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin Lejen e ndërtimit për objektin e realizuar. Kjo kërkesë, nuk ka të bëjë me qëllimin e përmbushjes së këtij kriteri, nga OE në garë, si dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, nenin 26 pika 6 germa b;

- Në procedurat e prokurimit, përsa i përket dokumentimit që duhet të paraqitet nga operatorët ekonomikë, për mjetet e transportit dhe lejet që duhet të disponojnë, nga NJP nuk është përcaktuar qartë dokumentacioni i kërkuar, për përmbushjen e këtij kriteri. Në DT, është kërkuar që të paraqitet "Leje transporti që lëshohet nga njësia vendore", ndërkohë që duhet të cilësonin saktë këtë kërkesë duke kërkuar "Leje transporti për përdorim për të tretë", veprim në kundërshtim me VKM, neni 26 "Kontrata për punë publike" pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (AK), konkretisht Njësia e Prokurimit (NJP) në përcaktimin e kriterëve kualifikuese, duhet të:

- analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kriterë të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, të qarta dhe të kuptueshme për operatorët ekonomikë, si dhe për çdo rast, duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës, që mbahet për këtë qëllim;
- shmangin vendosjen e kërkesave, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Këlcyre, nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konkretisht:

- Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, gjë e cila është reflektuar në mangësinë e plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.
- Nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitet 2018, 2019 dhe 2020 edhe pse në Ministrinë e Financave në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, është raportuar nëpërmjet pyetësorit të plotësuar, ekzistenca e një GMS të ngritur me urdhër nga titullari.
- Në strukturën organizative për vitet objekt auditimi pavarësisht se është përcaktuar pozicioni i punës së Përgjegjës të zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juristit, ky pozicion rezulton të jetë vakant për gjithë periudhën e audituar, ndërkohë që nuk ka asnjë shpallje për vend të lirë pune.
- Bashkia Këlcyre, nuk ka miratuar në strukturë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, strukturë kjo e rëndësishme për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve, por edhe për mbrojtjen e territorit.
- Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2018, 2019 dhe 2020, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.
- Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, si dhe nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.
- Nga auditimi i dosjeve të punonjësve u konstatua se përgjithësisht, nuk ishte nënshkruar kontrata e punës, siç përcaktohet nga Kodi i Punës, por ishte mjaftuar vetëm me Urdhrin e emërimit të nxjerrë nga Titullari.
- Gjithashtu, u konstatua se një numër i konsiderueshëm punonjësish, kanë rregulluar marrëdhënien e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që pozicionet e tyre të punës, evidentohen si pozicione me status “Nëpunës Civil” dhe për rrjedhojë rekrutimi i tyre është bërë në kundërshtim me ligjin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Këlcyre, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshtimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.
- Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të hartohet strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

- Plotësimin e pozicioneve vakante si: Përgjegjës i zyrës së Burimeve Njerëzore dhe pozicionin e Juristit të njësisë, Auditues të brendshëm, Inspektorë të kontrollit të territorit, si pozicione të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit në mënyrë ligjore.
- Ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme.
- Hartimin dhe plotësimin e gjitha dosjeve të punonjësve me kontratën individuale të punës, konform përcaktimeve të “Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë”.
- Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civilë”, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si punonjës bazuar në “Kodin e Punës”, si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Bashkia Këlcyrë, nuk ka një strukturë funksionale të auditit të brendshëm, pavarësisht caktimit në organikë të një pozicioni për auditues. Ky pozicion rezulton vakant për gjithë periudhën e auditimit. Titullari i institucionit, në mungesë të Njesisë së Auditit të Brendshëm, nuk ka lidhur marrëveshje me njësi tjera publike të cilat kanë njësi auditit të brendshëm, si dhe kapacitete të nevojshme për kryerjen e auditit të brendshëm në sektorin publik, veprime në kundërshtim me ligji nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10 germa (a) dhe (c) dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, neni 6 germa (a).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në një nga format e përshtatshme që përcakton kuadri ligjor.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se:

- Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, ka nxjerrë Urdhrin nr. 75, datë 31.08.2018 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e programit të punës dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së” në tejkallim të afateve të përcaktuara në ligjin nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Shkresa përcjellëse e KLSH për dërgim Raporti Përfundimtar Auditimi dhe Rekomandime me nr. 248/10, datë 29.06.2018, është protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me nr. 1364, datë 04.07.2018, ç’ ka do të thotë se afati i fundit për dërgimin e përgjigjes mbi programin/planin e masave për zbatimin e rekomandimeve është 25.07.2018. Ky urdher ka dalë 36 ditë më vonë. Gjithashtu, Grupi i punës, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për hartimin e programit për masat që duhet të merren për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë edhe pse me vonesë. Nga Bashkia Këlcyrë, nuk është dërguar në KLSH, programi (plan veprimi) mbi masat që duhet të ndërmerren nga subjekti, mbi zbatimin e rekomandimeve, brenda afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", germa (j);
- Mbi zbatimin e plan-veprimit dhe raportimin në KLSH, nga auditimi rezultoi se, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 248/10, datë 29.06.2018, i ka dërguar Bashkisë Këlcyrë, Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Shkresën përcjellëse me rekomandimet e lëna. Bashkia Këlcyrë, duhet të raportojë me shkrim mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve brenda 6-muajsh, nga marrja e Raportit të Auditimit dhe Shkresës përcjellëse mbi rekomandimet e lëna. Bashkia Këlcyrë nuk e ka zbatuar këtë detyrim ligjor, pasi nuk ka raportuar me shkrim në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014

“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit”;

- Nga auditimi rezultoi se Bashkia Këlcyrë, nuk ka bërë raportime në Këshillin Bashkiak, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i jashtëm (KLSH), referuar kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 113-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1. Rekomandim: Nga ana e Këshillit Bashkiak të analizohet gjendja e konstatuar në këtë auditim, të nxirren përgjegjësitë si dhe t’i kërkohej Kryetarit të Bashkisë, që të raportojë rregullisht, mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, ka rezultuar se:

- Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 14 “Masa organizative”, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 4 masa; janë zbatuar pjesërisht 4 masa; është në proces zbatimi 1 masë dhe **nuk janë zbatuar 5 masa.**

- Në auditimin e mëparshëm, janë rekomanduar 11 masa shpërblim dëmi, në vlerën 38,657,994 lekë, të pranuar dhe për të cilat kanë dalë njoftimet nga Titullari. Nga auditimi rezultoi se, **nuk janë kontabilizuar dhe nuk është arkëtuar asnjë vlerë.** Nga Bashkia Këlcyrë, nuk është paraqitur asnjë argumentim ligjor, për mos arkëtimin e dëmit, si dhe nga subjektet dhe punonjësit e atakuar, nuk është kryer ankimim në Gjykatën Administrative, për kundërshtim të shpërblimit prej tyre, të dëmit ekonomik të ngarkuar.

- Për shkeljet e konstatuara në auditimin e mëparshëm, janë dhënë masa disiplinore dhe administrative për t’u zbatuar nga strukturat përkatëse të ngarkuara me ligj. Nga auditimi ka rezultuar se nga 6 masa disiplinore, të rekomanduara nga KLSH dhe 2 masa disiplinore, të dhëna nga APP deri më 30.06.2020, janë zbatuar plotësisht 5 masa dhe janë zbatuar pjesërisht 3 masa disiplinore.

- Në auditimin e mëparshëm, KLSH i është drejtuar APP-së, për dhënien e masave administrative për 7 punonjës. Nga APP, ka dalë vendimi nr. 109, datë 16.11.2018, protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me nr. 2264, datë 20.11.2018, për vendosjen e gjobave për 9 punonjës dhe masa disiplinore për dy punonjës. Nga auditimi ka rezultuar se janë zbatuar masat disiplinore të dhëna nga APP për dy punonjës, por nuk është zbatuar asnjë prej 9 masave administrative “gjobë” për 9 punonjës. Nga ana e subjektit janë pranuar gjobat e vendosura nga APP, pasi kanë dalë Njoftimet e titullarit për personat përkatës, si dhe nga ana e personave të atakuar, përse i përket gjobave të vendosura nga APP, nuk ka ankime në Gjykatën Administrative, për rrjedhojë nuk ka asnjë argument ligjor për mos kontabilizim dhe mos arkëtim të tyre në vlerën totale 1,400,000 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 113-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1. Rekomandim: Këshilli Bashkiak, të marrë në analizë rezultatet e auditimit mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë, pasi për shkak të moszbatimit të tyre, **edhe në auditimin e radhës janë evidentuar shkelje, mangësi, si dhe veprime, në kundërshtim me kriteret e vlerësimit, të cilat janë të përsëritura.** Nga ana e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Këlcyre, t’i kërkohej Kryetarit të Bashkisë, marrja e masave për shqyrtimin, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e mëparshëm, të cilat rezultojnë të pa zbatuara apo të zbatuara pjesërisht, të trajtuara rast pas rasti, në mënyrë të hollësishme në Aneksin nr. 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

D.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe

mbështetur në Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102; Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 93, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Këlcyre), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi zbatues të ndiqet procesi me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 16,342,059 lekë** si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi se vlera **16,342,059** lekë nuk është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 –debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2021 (bilanci vjetor 2021) vlera prej **16,342,059** lekë. Nga verifikimi rezultoi nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej **16,342,059** lekë. Deri më datën 20.05.2022 nuk është arkëtuar asnjë lekë.

Nga ana e Bashkisë Këlcyre më datë 17.05.2022 mbas programit të auditimit është bërë njoftimi i subjekteve për detyrimet e konstatuara nga KLSH dhe deri në momentin e verifikimit nuk është ndërmarr asnjë procedurë tjetër për sa më sipër rekomandimet për masa shpërblim dëmi do të konsiderohen të pa realizuar si vijon:

Rekomandimet, arkëtimet dhe natyra e rasteve të mos realizimit të tyre:

Nr	Emër Mbiemër/Subjekti	Numri rekomandimit sipas shkresës (Vendimit)	Natyrë e Shkeljes	Rekomanduar Gjithsej në Lekë	Nuk Pranohen nga Subjekti	Janë pranuar Në lekë	Nga të pranuarat:			
							Arkëtuar Deri 15.05.21	Në Proces Arkëtim	Në Proces Gjyqësor	Nisur Njoftime e s'kanë Paguar
a	b	c	d	1	2	3 (2-1)	4	5	6	7
1	D.-Oil E.Shpk D. A.Shpk	1.1	Autorizim Karburantet	11,000,000						Po
2	J. SHPK	2.1	Punimeve të pakryera	1,951,600						Po
3	H. SHPK	3.1	Punimeve të pakryera	1,280,596						Po
4	(sipas Tabelës nr.2.3.10 “Tarifat për subjektet me investime mbi 5 milionë lekë”	4.1	Nipt sekondar	1,165,000						
5	H. SHPK	5.1	Punimeve të pakryera.	591,263						Po
6	z. S. V. dhe z. B. I.	6.1	Përlllogaritje e gabuar e fondit limit	353,600						Po

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nga Bashkia Këlcyre dhe Njësitë Administrative, për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, nuk është vepruar në përputhje me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35, VKM nr.170, datë 25.04.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar kapitulli II, kapitullit III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II pika 1, germa b dhe VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa shtresa dhe ndryshime në VKM nr. 970, datë 02.12.2015”, pasi ka mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e

detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative (Dishnice, Sukë dhe Ballaban), **nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet në shumën prej 11,000,000 lekë.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej **11,000,000 lekë**, për 4 subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pa pajisur me autorizim/licencë për tregtimin e karburanteve, kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM nr.344 datë 19.04.2017, respektivisht për subjektet si më poshtë:

- Subjekti D.-OIL, për vlerën prej 2,200,000 lekë.
- Subjekti E.SHPK, për vlerën prej 4,400,000 lekë.
- Subjekti D., për vlerën prej 3,300,000 lekë.
- Subjekti A. SHPK, për vlerën prej 1,100,000 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, me vlerë të kontratës (me TVSH) 34,858,247 lekë dhe kontraktor subjektin “**J.**” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,951,600 lekë pa TVSH, në zërat “FV pusetë plastike 40x40x40, kapak të fortë, çmimi”, “Shtresë asfaltobetoni”, “Spërkatje me emulsion bituminoz 1 lt/m²”, “Shtresë stabilizanti t=10 cm”, “Shtresë çakulli mbeturinë kave t=15 cm”, “Pllaka guri 40 x 40 cm ranor dhe gëlqeror për rrugë t=6-10 cm, çmimi”, “Gërmim dheu me krahë, kat IV, çmimi” dhe “Shtresë rëre nën dhe mbi tubacione”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. ..., datë 07.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe kontraktorit “**J.**” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,951,600 lekë pa TVSH**, nga kontraktori “**J.**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas Kontratës me nr., datë 07.05.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë, vlerë e cila përfaqëson, dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi” Bashkia Këlcyrë, me vlerë të kontratës (me TVSH)27,384,647 lekë, me kontraktor “**H.**” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,280,596 lekë pa TVSH në zërat e punës “Gërmim kanali tokë e zakonshme” dhe “Beton C16/20 veshje kanal betoni”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr., datë 01.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe kontraktorit “**H.**” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,280,596 lekë pa TVSH** nga kontraktori “**H.**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas Kontratës me nr., datë 01.07.2019, me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi” Bashkia Këlcyrë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën për ngritje kantier ndërtimi (investime publike), tarifë pastrimi për subjektet fituese të investimit deri në 5 milionë lekë, tarifë për ngritje kantier ndërtimi tarifë pastrimi për subjektet fituese të investimit mbi 5 milionë lekë, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Këlcyrë dhe Njësi Administrative në vartësi. Nga përllogaritjet e kryera rezulton se nuk janë aplikuar tarifatat për kantier ndërtimi dhe pastrimi për 9 subjekte ndërtimi (sipas Tabelës nr.2.3.10 “Tarifat për subjektet me investime mbi 5 milionë lekë”, faqe 38 Raportit Përfundimtar të Auditimit), në vlerën totale prej 1,615,000 lekë. Vlera prej **1,165,000 lekë**, e cila përfaqëson mos arkëtim të tarifave për kantier ndërtimi dhe tarifë pastrimi, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues gjatë procedurave të prokurimeve publike, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e shumëve prej **1,165,000 lekë** si rezultat i mos aplikimit të tarifave vendore për kantier ndërtimi dhe tarifatat e pastrimit për 9 subjektet që kanë kryer investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Këlcyrë.

4.2. Rekomandim: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë, të merren masat, që në çdo rast, subjektet përpara nisjes efektive të veprimtarisë, sipas vendndodhjes të objektit të kontratës, të kryejnë aplikimin për regjistrimin e hapjes së vendit të ushtrimit të veprimtarisë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran Fushë, Rruga Goricë, Rruga Komarak e Vinokash, Rruga Gur Fshat Këlcyrë, Rruga Riban, Bashkia Këlcyrë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 36,353,317 lekë, me kontraktor “**H.**” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 591,263 lekë pa TVSH në zërat e punës “Strukturë monolite betoni C 16/20 për koka pusete”, “Strukturë monolite betoni C 12/15 me zgarë metalike 6 mm”, “Shtresë çakulli 15 cm” dhe “Shtresë çakulli mbeturinë kave t=10 cm, përhapur e ngjeshur me makineri”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr., datë 10.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe OE “**H.**” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **591,263lekë pa TVSH** nga kontraktori “**H.**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr., datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran Fushë, Rruga Goricë, Rruga Komarak e Vinokash, Rruga Gur Fshat Këlcyrë, Rruga Riban”, Bashkia Këlcyrë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përllogaritjen e vlerës limit të kontratave, rezultoi se vlera limit e kontratës, për procedurën me objekt “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të Ujësjellësit Këlcyrë” është përllogaritur 803,300 lekë më shumë. Kjo për shkak se nga preventivuesi dhe Grupi i punës për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, i përcaktuar me Urdhrin datë 24.05.2019 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nuk është zbatuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime pika 3.1, për zërin e punimeve 2.197 “Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese katrama”. Për këtë zë punimesh sipas Manualit nr. 2, çmimi është 1,232 lekë/njësi, ndërsa nga preventivuesi dhe Grupi i punës është përllogaritur 12,312 lekë/m², pra 11,080 lekë/m² më shumë. Diferenca

për gjithë sasinë është 803,300 lekë ($72.5 \text{ m}^2 * 11,080 \text{ lekë/m}^2=803,300 \text{ lekë}$). Nga auditimi i procedurës ka rezultuar se diferenca midis ofertës fituese dhe vlerës limit të kontratës është 449,700 lekë. Sa më sipër, diferenca në shumën 353,600 lekë midis vlerës së fondit limit të përlllogaritur më tepër dhe diferencës së ofertës fituese kundrejt vlerës limit të kontratës, konsiderohet dëm ekonomik ($803,300-449,700=353,600 \text{ lekë}$) dhe duhet të shpërblehet nga shkaktarët e këtij dëmi, Grupi i punës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK), të marrë masa për arkëtimin e shumës prej **353,600 lekë**, nga z. **S. V.** dhe **B. I.**, si personat përgjegjës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, referuar Urdhrit të Titullarit të AK, datë 24.05.2019 “Komisioni i ngarkuar për përlllogaritjen e fondit limit”.

Menjëherë

D.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

Nga verifikimi rezulton se Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 3 masa në vlerën 55,970,640 lekë, e pranuar dhe e pa zbatuar, si vijon:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2019, detyrimet ndaj Bashkisë Këlcyrë, janë në vlerën gjithsej **60,386,981** lekë. Kjo gjendje debitorë është krijuar nga **220** subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, për vlerën **22,853,022** lekë, (e pa kontabilizuar), dhe **3,360** familje për detyrime të pa përlllogaritura për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej **37,533,959** lekë. Nga krahasimi i të dhënave midis vlerës së detyrimeve të pashlyera sipas të dhënave që disponon Sektori i Tatim Taksave Vendore, me vlerën që paraqet Sektori i Financës në pasqyrat financiare, (llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”) nuk paraqet vlerën reale të detyrimeve. Sipas bilancit të vitit 2018, detyrimet janë në shumën 6,078,000 lekë, e pandryshuar edhe në bilancin e vitit 2019, dhe sipas përlllogaritjeve të bëra nga Grupi i Auditimit referuar të dhënave të marra nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, gjendja reale e debitorëve është në vlerën prej 60,386,981 lekë, pra konstatohet një diferencë e dukshme në vlerën prej **54,308,981 lekë, vlerë kjo e cila është e pa kontabilizuar.**

-Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave për 48 bizneset që rezultojnë me status pasiv, nuk janë mbajtur akt- konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit.

-Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 220 subjekte debitorë (fizik/juridik) në vlerën **22,853,022 lekë**, janë aktiv 172 subjekte ose 78% e totalit të debitorëve të evidentuar, të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa.

Sektori i Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, ka zbatuar vetëm procedurën e bllokimit të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe **asnjë procedurë tjetër**, ku dhe kjo procedurë që në fillimet e saj rezulton e dështuar, sidomos për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë të deklaruar pranë sektorit të taksave nr. llogarie bankare, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo nëpërmjet bankës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë të marrë masat për të ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, **për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 220 subjekte për vlerën 22,853,022 lekë dhe 3,360 familje për vlerën gjithsej 37,533,959 lekë**, bazuar në neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit

tatimor” ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- T`u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime ne llogarit bankare;
- T`i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe “Sektori Juridik”, të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, **në 6 procedura**, sipas Tabelës anekse nr. 4.5 “Efektet financiare”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, si rezultat i vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me aktet rregullative, është shkaktuar përdorim i fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficencë, **në shumën 23,967,868 lekë**. Efektet negative, janë shkaktuar si rezultat i kualifikimit të Operatorëve Ekonomikë (OE) të shpallur fitues, në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. OE, janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DT, të hartuara nga Njësia e Prokurimit e të miratuara nga Titullari i AK, duke mos garantuar përmbushjen me cilësi të kontratës, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të vendosura në DT. Diferenca midis OE me ofertën më të ulët dhe OE të shpallur fitues, në kushtet kur asnjë prej tyre nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, është konsideruar paligjshmëri në prokurimin e fondeve publike, me pasojë përdorim pa efektivitet ekonomikitet dhe eficencë të fondeve publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Këlcyrë, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë nga ana e KVO-së, të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në DT, për përmbushjen e “Kriterëve të veçanta për kualifikim”, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të cilat janë në kundërshtim me aktet rregullative të fushës, si dhe me pasojë në përmbushjen me cilësi të kontratës në këto investime, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të vendosura në DT.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, konstatojmë se ka mospërputhje të theksuar midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar, sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se, Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në Bashki, për të grumbulluar evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se planifikimi i taksës së tokës bujqësore për dy vitet 2018 dhe 2019, është në shumën 4,950,000 lekë dhe për vitin 2020 në shumën 1,417,000 lekë, ndërsa referuar të dhënave të Sektorit të Bujqësisë në Bashkinë Këlcyrë, planifikimi për vitet 2018 dhe 2019, duhej të ishte në shumën 10,854,000 lekë dhe për vitin 2020 duhej të ishte në shumën 5,904,500 lekë. Sa më sipër,

rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, është planifikuar më pak e ardhura nga këto taksa e tarifa për vlerën 9,914,750 lekë, në kundërshtim me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Projekt Raportit të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të Sektorit të Bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, në shumën prej **9,914,750 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë.

Menjëherë

E. MASA ADMINISTRATIVE

E.1. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësiive individuale të evidentuara dhe pasqyruara në dokumentet e auditimit (Aktkonstatime, Projektraport Auditimi dhe Raport Përfundimtar Auditimi), mbështetur në nenet 13 “Agjencia e Prokurimit Publik” dhe 72 “Kundërvajtjet administrative” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 germa (c) dhe (ç), si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me këto shkelje, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për 3 punonjës.

Nga verifikimi rezultoi se Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar APP marrjen e masës administrative me gjobë për 3 persona. APP me Vendimin nr. 82 datë 24.11.2021 ka vendosur marrjen e masës administrative me gjobë për 4 persona në vlerë totale 320,000 leke. Deri në momentin e verifikimit rezultoi se Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk ka ndërmarr asnjë veprim në zbatim të vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 2784 prot datë 26.11.2021, për të cilat KLSH rikërkon zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara. Në mënyrë të detajuar masat e rekomanduara nga KLSH paraqiten si vijon:

1. Z. A. Q., Për shkeljet e konstatuara në 9 procedura prokurimi me objekt “Punë publike”, dhe “Blerje mallrash”.

2. Znj. R.H., në cilësinë e anëtares së KVO-së, në 9 procedura prokurimi me objekt “Punë publike”, dhe “Blerje mallrash”.

3. Z. E. L., në cilësinë e anëtarit të KVO-së, në 6 procedura prokurimi me objekt “Punë publike”, dhe “Blerje mallrash”

Shtuar APP

4. Z. A. L., me detyrë specialist i Kadastrës, në cilësinë e anëtarit të KVO-së

Rekomandim pas verifikimit të detyrave: Bashkia Këlcyrë, bazuar në nenet 151, dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”, të marrin masa për arkëtimin vlerës 320,000lekë ndaj 4 punonjësve dhe ish punonjësve ndaj të cilëve nuk është kryer asnjë procedurë sipas vendimit të APP.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

IV. ANEKSE

Aneksi 1

Evidenca përmblledhëse e realizimit të detyrave të rekomanduara për 2 subjektet

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Në % si numër	Në % si vlerë	Statusi i rekomandimeve të pranuar									
		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera			Zbatuar		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	26		26				100		4						22			
2	Masa shpërblim dëmi	8	17,789	8	17,789			100	100			1	584			6	16,342	1	863
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																		
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	1	183,894	1	183,894			100	100			1	183,894		183,894				
4	Mungesë të ardhurat	5	101,295	5	101,295			100	100			2	45,325	17,646	27,679	3	55,970		
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																		
5	Masa disiplinore	10		10				100	100	10									
	- Me Status Nënpunësi Civil																		
	- Me kontratë pune																		
6	Masa Administrative	24		36	1,940			100	100	15	540					11	780	10	620
	- Nga APP																		
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																		
	-Nga IMTV																		
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																		
11	Tjera																		
	TOTALI	74	302,978	86	304,918			100	100	29	540	4	229,803	17,646	211,573	42	73,092	11	1,483

ANEKSI 2

PASQYRA E MASAVE ORGANIZATIVE DHE KTHIM PËRGJIGJE, PËR 2 SUBJEKTET

Në 000/lekë

Nr.	SUBJEKTET	Zbatimi afateve		Masa Organizative														
		20 ditëve	6 muaj	Rekomandim	Vlera	Pranu	Vlera	Zbatuar	Vlera	Proces	Vlera	Arkëtuar	Mbetje	Pazbatuar	Vlera	VGJ	Vlera	
1	APR	1	0	4		4		4										
2	Bashkia Këlcyrë	0	0	22		22								22				
	SHUMA	1	0	26		26		4						22				

ANEKSI 3

PASQYRA E MASAVE SHPËRBLIM DËMI, PËR 2 SUBJEKTET

Në 000/lekë

Nr.	SUBJEKTET	Masa shpërblim dëmi														
		Rek	Vlera	Pranu	Vlera		Zbatuar	Vlera	Proces	Vlera	Arkëtuar	Mbetje	Pa zbatuar	Vlera	VGJ	Vlera
1	APR	2	1,447	2	1,447				1	584					1	863
2	Bashkia Këlcyrë	6	16,342	6	16,342								6	16,342		
	SHUMA	8	17,789	8	17,789				1	584			6	16,342	1	863

Aneksi 4

PASQYRA ,OS EFEKTIVITET TË FONDE PUBLIKE (3-E), PËR 2 SUBJEKTET

Në 000/lekë

Nr.	SUBJEKTET	Mos efektivitet te fondeve												
		Rek	Vlera	Pranu	Vlera		Zbatuar	Vlera	Proces	Vlera	Arkëtuar	Mbetje	Pa zbatuar	Vlera
1	APR	1	183,894	1	183,894				183,894					
2	Bashkia Këlcyrë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	SHUMA													

Aneksi 5

PASQYRA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

Në 000/lekë

Nr.	SUBJEKTET	Mungese të ardhurash dhe borxhi													
		Rek	Vlera	Pranu	Vlera	Zbatuar	Vlera	Proces	Vlera	Arkëtuar	Mbetje	Pa zbatuar	Vlera	VGJ	Vlera
1	APR	2	45,325	2	45,325			2	45,325	17,646	27,679				
2	Bashkia Këlcyrë	3	55,970	3	55,970							3	55,970		
	SHUMA	5	101,295					2	45,325	17,646	27,679	3	55,970		

Aneksi 6

PASQYRA E MASAVE DISIPLINORE, PER 2 SUBJEKTET

Nr.	SUBJEKTET	Masa disiplinor			
		Rekomandim	Pranuar	Zbatuar	Pa zbatuar
1	APR	4	4	4	
2	Bashkia Këlcyrë	6	6	6	
	Shuma	10	10	10	

Aneksi 7

PASQYRA E MASAVE ADMINISTRATIVE, PER 2 SUBJEKTET

Në 000/lekë

Nr.	SUBJEKTET	Masa Administrative													
		Rek	Vlera	Pranuar	Vlera	Zbatuar	Vlera	Proces	Vlera	Arkëtuar	Mbetje	Pa zbatuar	Vlera	VGJ	Vlera
1	APR	21		32	1,620	15	540					6	400	11	680
2	Bashkia Këlcyrë	3		4	320							4	320		
	Shuma	24		36	1,940	15	540					11	720	10	680

